



Funded by  
the European Union

# ARSIMIMI I KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË





**ARSIMIMI I KOMUNITETEVE ROM,  
ASHKALI DHE EGJIPTIAN  
NË KOSOVË**

## ARSIMIMI I KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

**Ky raport është hartuar nga:**

Veton Sylhasi

Nëntor 2021, Prishtinë

**Publikuar nga programi njëvjeçar “Cilësia, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja në arsim 2021”**

Për më shumë informata, vizitoni: [www.kec-ks.org](http://www.kec-ks.org)

Design: *envinion*:



**Funded by  
the European Union**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit njëvjeçar “Cilësia, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja në arsim 2021”, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

# Përmbajtja

<b>FALËNDERIM.....</b>	<b>5</b>
<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>8</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>12</b>
QËLLIMI I STUDIMIT .....	13
METODOLOGJIA E STUDIMIT .....	13
KUFIZIMET E STUDIMIT .....	18
<b>KONTEKSTI I STUDIMIT.....</b>	<b>19</b>
QASJA E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT.....	19
KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN SI GRUP I CENUESHËM NË ARSIM .....	20
<b>ZHVILLIMET NË FUSHËN E ARSIMIMIT TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DH EGJIPTIAN.....</b>	<b>24</b>
STIMULIMI DHE LEHTËSIMI I REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË NIVELEVE TË NDRYSHME TË ARSIMIT.....	24
VETËDIJESIMI PËR RËNDËSINË E REGJISTRIMIT ME KOHË DHE VIJIMIN E SHKOLLIMIT.....	26
LEHTËSIMI I REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË FËMIJËVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË NIVELIN PARASHKOLLOR DHE ARSIMIN E MESËM.....	26
STIMULIMI PËRMES SISTEMIT TË BURSAVE DHE MENTORIMIT .....	27
LEHTËSIMI I REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË STUDENTËVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË ARSIMIN E LARTË.....	29
PUNA E QENDRAVE MËSIMORE.....	30
FAZA E HERSHME E QENDRAVE MËSIMORE.....	30
INSTITUCIONALIZIMI I QENDRAVE MËSIMORE.....	30
PUNA AKTUALE E QENDRAVE MËSIMORE.....	31

ADRESIMI I BRAKTISJES .....	32
RIINTEGRIMI NË ARSIM I FËMIJËVE TË RIKTHYER.....	39
ARSIMI DHE AFTËSIMI PËR TË RRITUR.....	41
PROMOVIMI I DIVERSITETIT PËRMES SISTEMIT TË INTEGRUAR ARSIMOR .....	43
ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA .....	45
NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 .....	45
MËSIMI I GJUHËS ROME .....	47
PROFESIONISTËT ARSIMORË TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN .....	47
BASHKËPUNIMI NDËRSEKTORIAL .....	49
<b>PËRFUNDIME.....</b>	<b>50</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>56</b>
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>59</b>

# Falënderim

Ky raport u hartua falë bashkëpunimit të shumë palëve të cilat kanë ofruar informata për nevoja të studimit, duke kontribuar në cilësinë e raportit. U jemi shumë mirënjohës dhe i falënderojmë për kontributin e tyre:

- Zyrtarët e MASHTI-t: Arian Mustafa, Avni Rexha, Merita Jonuzi, Nazan Safçi, zyra e SMIA;
- Dekanatet e fakulteteve të edukimit: Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë, Prizren;
- Komunitatet: Fushë Kosovë, Gjakovë, Podujevë;
- Organizatat: Bethany Christian Services Kosovo, Balkan Sunflowers Kosova, Nevo Koncepti, Roma in Action, SHL-Kosova, Syri i Vizionit, Terre des hommes-Kosovo, The Ideas Partnership, Voice of Roma, Ashkali and Egyptians
- Mësimdhënëset: Emel Qehaja Elshani, Indra Jashari, Urma Menekshe
- ZKKK Gjakovë: Pranvera Kershaj
- Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë: Vjosa Rogova Damoni
- Caritas Switzerland in Kosovo: Albert Bakalli

Për kontributin e dhënë përmes informatave e konsultimeve gjatë hulumtimit, i falënderojmë edhe kolegët nga Qendra për Arsim e Kosovës: Hana Zylfiu Haziri, Petrit Tahiri, Sofije Toska

## Lista e shkurtesave

<b>AARr</b>	Arsimi dhe Aftësimi për të Rritur
<b>ADA</b>	Agjencia Zhvillimore e Austrisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CDBE</b>	Projekti i GIZ “Ngritja e kapaciteteve në arsimin fillor”
<b>COVID-19</b>	CO (Coronavirus), VI (Viral), D (Disease)
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>EPRBM</b>	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
<b>EU-SIMRAES 2</b>	Projekti “Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2- Arsim për Integrim”
<b>EWC</b>	Qendra Evropiane Wergeland
<b>GIZ</b>	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>IAL</b>	Institucionet e arsimit të lartë
<b>IAP</b>	Institucionet e arsimit parashkollor
<b>INCLUDE</b>	Projekti i përbashkët i BE/KiE “Ndërtimi i kapaciteteve për gjithëpërfshirje në arsim”
<b>IPE</b>	Projektet ndërkombëtare në arsim
<b>HEKS/EPER</b>	Ndihma e kishave protestante zvicerane
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>KFOS</b>	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
<b>KEC</b>	Qendra për Arsim e Kosovës



<b>KIE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KOSINT</b>	Projekti “Iniciativa e Kosovës për integrim 2020”
<b>KRAEEYN</b>	Rrjeti i Kosovës për edukimin e hershëm të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MICS</b>	Anketa e Treguesve të Shumëfishtë
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë
<b>OShC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>QM</b>	Qendra Mësimore
<b>REF</b>	Fondi për Arsimimin e Romëve
<b>SDC</b>	Agjencia për Zhvillim e Zvicrës
<b>SMIA</b>	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimit
<b>SPH</b>	Moduli i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm
<b>UA</b>	Udhëzimi Administrativ
<b>UNICEF</b>	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>VoRAE</b>	Organizata Voice of Roma, Ashkali and Egyptians
<b>ZKKK</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

## Përmbledhje ekzekutive

Gjithëpërfshirja është parimi themelor në sistemin e arsimit, që përkthehet në respektimin e normave të miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, me fokus në ofrimin e mundësive të barabarta për grupet e ndjeshme në shoqëri. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë njëri nga grupet e cenueshme dhe për arsimimin e tyre nevojiten masa të posaçme në mënyrë që t'u sigurohet përfshirja dhe cilësia e duhur e arsimimit. Përfshirja e këtyre komuniteteve në sistemin e arsimit në Kosovë rregullohet përmes një legjislacioni gjithëpërfshirës dhe politikave arsimore gjithëpërfshirëse. Politika të këtilla që adresojnë përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim janë dy strategji 5-vjeçare që tashmë janë në fund të periudhës implementuese. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare u miratua në vitin 2017 dhe organizohet në katër fusha strategjike të veprimit, ndër të cilat njëra është arsimi. Në kuadër të kësaj fushe është planifikuar një numër i aktiviteteve për periudhën deri në vitin 2021. Plani strategjik i arsimit në Kosovë (PSAK) është miratuar po ashtu në vitin 2017 dhe përmban masa për të rritur përfshirjen dhe cilësinë e arsimit për anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ky raport shfrytëzon informatat nga palët e ndryshme të përfshira në aktivitetet e drejtuara në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe të dhënat nga burimet dytësore për të kuptuar shkallën dhe cilësinë e zbatimit të politikave arsimore të përqendruara në arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Më saktësisht raporti pasqyron punën që është bërë në vitet e fundit, praktikatat e mira, vështirësitë e ngecjet.

**Qëllimi i këtij studimi** ishte që të analizohet situata me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si në rrafshin e zbatimit të politikave arsimore ashtu edhe në rrafshin e përvojave konkrete të ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve arsimore. Më në thellësi, përmes këtij hulumtimi është mëtuar të kuptohen zhvillimet në aspektet e ndryshme të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

**Metodologjia e përdorur** për të analizuar situatën me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është e kombinuar. Ndërsa të dhënat sasiore të shfrytëzuara janë në funksion të këtij studimi, thelbi i studimit është i natyrës cilësore. Fillimisht janë mbledhur të dhëna dytësore përmes një studimi kabinetik, duke shqyrtuar legjislacionin, politikat, raportet e dokumentet e tjera në fushën e arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe në fusha të ndërlidhura. Më tej, janë zgjedhur dy dokumentet strategjike që kanë treguar rrugën që është dashur ta përshkojë shoqëria jonë në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në 5 vitet e fundit, për të identifikuar tema të veçanta që janë bërë pjesë e këtij studimi. Pra studimi është strukturuar nëpër tema të veçanta dhe për këto tema janë kërkuar të dhëna cilësore, të cilat janë mbështetur edhe me të dhëna sasiore, kudo që ka qenë e mundur.

Për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar pyetësorët e shkurtër me pyetje të hapura, ku palëve u është kërkuar të japin kontributet e tyre përmes informatave të dorës së parë. Varësisht nga nevoja, pyetësorët janë plotësuar me intervista me ato palë për të qartësuar ndonjë aspekt të studimit dhe për të nxjerrë informata më

të thella. Në disa raste, janë mbajtur intervista me disa palë, pasi atyre palëve u është dërguar pyetësori për t'i orientuar rreth intervistës. Përfundimisht, të dhënat e mbledhura së voni në një punëtori me përfaqësues të 6 komunave dhe OShC nga këto komuna janë shfrytëzuar për një pjesë të studimit.

**Studimi ka ardhur te përfundimet** se në fushën e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është bërë përparim i dukshëm në vitet e fundit, sikurse mbetet akoma mjaft punë për t'u bërë. MASHTI tashmë e ka marrë rolin si institucion udhëheqës në disa aspekte të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në aspekte të tjera vërehen përpjekje, por po ashtu vështirësi. Komunitet, në nivel të së cilave bien shumë përgjegjësi për arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, po ashtu e kanë shtuar angazhimin, megjithëse ende nuk kanë arritur ta marrin kryesimin e aktiviteteve në këtë drejtim. Shpesh qasja e komunave është reaktive, në varësi të nismave e kërkesave që vijnë nga OShC-të. Lidhur me institucionet, janë hasur mungesa të të dhënave të besueshme si dhe raportim dhe monitorim jo i mjaftueshëm. Informatat nuk qarkullojnë si duhet në nivelin vertikal. Shumë aktivitete që është dashur të kryhen në nivel komunal kanë munguar, sidomos ato që lidhen me rregulloret dhe planet në nivel lokal, ndërsa nga niveli qendror nuk ka pasur monitorim.

Ka vazhduar përkrahja e komunitetit donator përmes projekteve në mbështetje të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por në të njëjtën kohë është artikulluar qartë kërkesa që institucionet të marrin përsipër koordinimin e veprimeve për rritjen e përfshirjes dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë edhe marrjen përsipër të financimit të këtyre veprimeve. Institucionet kanë reaguar pozitivisht. Ndërsa është vërejtur aktivitet i shtuar i vetë anëtarëve të këtyre komuniteteve, aktivistëve dhe OShC-ve që punojnë në arsimimin e këtyre komuniteteve. OShC-të në shumicën e rasteve janë në pararojë të adresimit të të gjitha nevojave të këtyre komuniteteve në aspektin arsimor dhe më gjerë.

Në përputhje me PSAK dhe strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali, janë realizuar shumica e masave për stimulimin dhe lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e ndryshme të arsimit. Masa të tilla përfshijnë: realizimin e kuotave për regjistrim (së paku 5 nxënës në shkollë) të nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin e arsimit të mesëm të lartë; përkrahjen e nxënësve të këtyre komuniteteve me bursa dhe mentorim, në një proces të përbashkët të të gjitha organizatave donatore, nën koordinim të MASHTI-t; dhe lehtësimi i regjistrimit të studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes vendeve të rezervuara. Ndërkohë, lidhur me bursat për studentët e arsimit të lartë, nuk është arritur të lehtësohet procesi për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Qendrat mësimore e kanë rritur standardin e operimit, përmes harmonizimit të programeve të tyre me kurrikulën e arsimit parauniversitar, si dhe përmes zhvillimit profesional të stafit dhe inkurajimit të stafit të vazhdojnë arsimin formal drejt kualifikimit për mësimdhënës. Po ashtu, ka nisur procesi i koordinuar i institucionalizimit të qendrave mësimore. Miratimi i UA 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore dhe hartimi i udhëzuesit për zbatimin e këtij UA e hapi rrugën për këtë proces. Tash ka nisur procesi i licencimit të QM-ve, gjë që ua mundëson QM-ve të financohen nga fondet publike.

Braktisja e shkollës dhe mosregjistrimi mbetet një faktor që rëndon dukshëm më shumë mbi fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. EPRBM-të në nivel shkollash dhe komunash janë të themeluara, por shpesh janë jofunksionale ose joefektive. Rolin e tyre, kur është fjala për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, më shumë e luajnë OShC-të dhe ndërmjetësuesit në komunitet. Raportimi i rasteve në modulën e paralajmërimit të hershëm është tejet i vogël. Vetëm 6 komuna dhe vetëm 14 shkolla nga këto komuna, kanë raportuar raste të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në SPH.

Për fat të keq MASHTI nuk posedon të dhëna të ndara sipas përkatësisë etnike lidhur me të rikthyerit, prandaj trajtimin e riintegrit arsimor e bën njëjtë për të gjithë fëmijët e rikthyer. Në nivelin lokal, bëhet riintegrimi i menjëhershëm në shkolla i fëmijëve të riatdhesuar, për të vazhduar pastaj sipas nevojës me vlerësimin e nivelit të nxënësve, me rregullimin e dokumentacionit dhe me kurset e gjuhës. Kur bëhet fjalë për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sërish janë OShC-të që ndihmojnë në identifikimin e nevojave, rregullimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e fëmijëve në shkollë.

Lidhur me arsimin dhe aftësimin për të rritur, në SMIA ka të dhëna për 8 komuna në të cilat gjatë 5 viteve të fundit nga programet e AARr kanë përfutur pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Janë së paku edhe tri komuna me numër të madh të këtyre komuniteteve që nuk figurojnë në këto statistika dhe kjo shtron pikëpyetje në këtë drejtim.

Ndonëse me PSAK ishte paraparë zhvillimi i një strategjie për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve, si dhe zhvillimi i një politike për organizimin e mësimdhënies për diversitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve për të gjithë nxënësit, këto dokumente nuk janë zhvilluar. Po ashtu, nuk është raportuar të jenë zhvilluar module arsimore specifike për komunitete. Këtë zbrazëti e kanë mbulluar projektet e implementuara dhe ato që implementohen nga agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë ngritur kapacitetet e udhëheqjeve shkollore dhe të mësimdhënësve, si dhe kanë ofruar udhëzues praktikë për kompetencat për kulturën demokratike në shkolla, që promovon diversitetin, tolerancën dhe bashkëjetesën.

Pandemia ndikoi më rëndë në situatën me arsimimin te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke zvogëluar qasjen e tyre në mësim, duke e ulur nivelin e të nxënësve, si dhe duke kufizuar ndërveprimin social. DKA-të dhe shkollat nuk kishin ndonjë plan të veçantë se si t'i adresonin nevojat e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian, por reagues brenda mundësive që kishin.

Derisa gjuha rome si lëndë me zgjedhje është ofruar vite më parë në disa komuna si Gjakova e Ferizaj, nuk është arritur të mbahet. Vetëm në komunën e Prizrenit është bërë një zgjidhje më e qëndrueshme, pasi është punësuar një mësimdhënëse rome dhe ajo e mban mësimin e gjuhës rome në katër shkolla të kësaj komune. Lëndën e gjuhës rome në këto shkolla e ndjekin edhe disa nxënës shqiptarë, sikurse edhe nxënës të komuniteteve të tjera.

Numri i studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që i ndjekin studimet në fakultetet e edukimit po rritet vit pas viti, rrjedhimisht edhe numri i të diplomuarve nga këto komunitete. Megjithatë, nuk shihet

rritje e numrit të mësimdhënësve të këtyre komuniteteve që punësohen në shkollat publike në Kosovë. Deri tash institucionet nuk kanë marrë masa për të rritur numrin e të punësuarve nga këto komunitete dhe në vend të kësaj kanë zgjedhur qasjen e trajtimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë etnike.

**Studimi ka nxjerrë disa rekomandime** të bazuara si në aspektet ku janë identifikuar vështirësi, ashtu edhe nga praktikave të mira. Disa nga rekomandimet janë të lidhura me politikave dhe legjislacionin dhe i drejtohen kryesisht MASHTI-t. Të tilla janë krijimi i mekanizmave të qartë kontrollues në kuadër të ciklit të ardhshëm strategjik; rishikimi i disa UA, për të krijuar mundësi për masa lehtësuese për fëmijët dhe studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; krijimi i politikës për kulturë demokratike me qëllim të promovimit të diversitetit, përfshirjes sociale dhe mirëkuptimit ndërkulturor, etj.

Rekomandimet tjera për MASHTI-n janë ato që lidhen me mbajtjen dhe me shpërndarjen e praktikave të mira nga përvoja paraprake, si ajo që lidhet me bursat, me financimin e qendrave mësimore dhe me shpërndarjen e praktikave të mira nga komunat në komuna.

Disa rekomandime lidhen me masa të mëtejme stimuluese për arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, dhe u drejtohen MASHTI-t dhe komunave, të tilla si: lirimi nga pagesa e nostrifikimit të dokumenteve të të rikthyerve; promovimi i mësimin të gjuhës romë dhe punësimi i mësimdhënësve të gjuhës romë; punësimin e mësimdhënësve të këtyre komuniteteve në shkollat publike përmes përparësisë në konkurse; etj.

# HYRJE

Kosova është e përcaktuar si shoqëri shumetnike, që qeveriset në mënyrë demokratike, mbi parimet e barazisë dhe respektimit të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë individëve, si dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre<sup>1</sup>. Pra, janë përqafuar standardet më të larta të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve, përfshirjes sociale dhe bashkëjetesës si elemente të funksionimit të shoqërisë.

Në sistemin e arsimit, gjithëpërfshirja është parimi themelor që përkthehet në respektimin e normave të miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, me fokus në ofrimin e mundësive të barabarta për grupet e ndjeshme në shoqëri<sup>2</sup>. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë njëri nga grupet e cenueshme dhe për arsimimin e tyre nevojiten masa të posaçme në mënyrë që t'u sigurohet përfshirja dhe cilësia e duhur e arsimimit. Përfshirja e këtyre komuniteteve në sistemin e arsimit në Kosovë rregullohet përmes një legjislacioni gjithëpërfshirës dhe politikave arsimore gjithëpërfshirëse. Politika të këtilla që adresojnë përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim janë dy strategjitë 5-vjeçare që tashmë janë në fund të periudhës implementuese. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare u miratua në vitin 2017 dhe organizohet në katër fusha strategjike të veprimit, ndër të cilat njëra është arsimi. Në kuadër të kësaj fushe është planifikuar një numër i aktiviteteve për periudhën deri në vitin 2021. Plani strategjik i arsimit në Kosovë (PSAK), po ashtu, është miratuar në vitin 2017 dhe përmban masa për të rritur përfshirjen dhe cilësinë e arsimit për anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ndërsa nuk kemi informata se institucionet kanë bërë vlerësim të implementimit të këtyre strategjive, një numër i raporteve janë publikuar kryesisht nga organizatat dhe japin të dhëna për shkallën e zbatimit të masave dhe arritjes së rezultateve e objektivave të këtyre strategjive. Duke qenë se institucionet e Kosovës e kanë nisur procesin për ciklin e ri strategjik, si lidhur me përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare, ashtu edhe me PSAK, pritet që të kemi një vlerësim të implementimit të strategjive pararendëse.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve dhe ndonëse i ndërlidhur me to, ky raport shfrytëzon informatat nga palët e ndryshme të përfshira në aktivitetet e drejtuara në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe të dhënat nga burimet dytësore, për të kuptuar shkallën dhe cilësinë e zbatimit të politikave arsimore të përqendruara në arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Më saktësisht raporti pasqyron punën që është bërë në vitet e fundit, praktikat e mira, vështirësitë e ngecjet.

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

2 Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

## QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i këtij studimi ishte që të analizohet situata me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si në rrafshin e zbatimit të politikave arsimore ashtu edhe në rrafshin e përvojave konkrete të ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve arsimore.

Më në thellësi, përmes këtij studimi është mëtuar të kuptohen zhvillimet në aspektet e ndryshme të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në mënyrë të veçantë, janë kërkuar përgjigje rreth këtyre pyetjeve:

- Cila është shkalla dhe cilësia e zbatimit të masave të përcaktuara me politikën arsimore që fokusohen në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian?
- Cilat janë përvojat në nivelin qendror, lokal dhe të komunitetit (vështirësitë, ngecjet, praktikën e mira, etj.), lidhur me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian?

## METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ndërsa të dhënat sasiore të shfrytëzuara janë në funksion të këtij studimi, thelbi i studimit është i natyrës cilësore. Metodologjia e përdorur për të analizuar situatën me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është e kombinuar.

Fillimisht janë mbledhur të dhëna dytësore përmes një studimi kabinetik, duke shqyrtuar legjislacionin, politikën, raportet e dokumentet e tjera në fushën e arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe në fusha të ndërlidhura. Dokumentet e shqyrtuara përfshijnë:

- Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- Legjislacionin arsimor në Kosovë;
- Strategjitë e përqendruara në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Strategjitë lokale dhe planet lokale të veprimit të përqendruara në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Raportet me statistika arsimore nga MASHTI për vitet 2015/16 – 2020/2021;
- MICS – Anketa e treguesve të shumëfishtë në Kosovë dhe anketa e treguesve të shumëfishtë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2019/2020;
- Raporte të ndryshme të lidhura me arsimimin e komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian.

Për ta zhvilluar më tej studimin, janë zgjedhur dy dokumente strategjike që kanë treguar rrugën që është dashur ta përshkojë shoqëria jonë në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në 5 vitet e fundit. Këto dy dokumente strategjike janë:

- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021<sup>3</sup>; dhe
- PSAK – Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021<sup>4</sup>.

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 është hartuar mbi katër fusha strategjike të veprimit, ku njëra prej tyre është arsimi, krahas punësimit, shëndetësisë dhe banimit që janë tri fushat e tjera. Për nevoja të këtij studimi është marrë fusha strategjike e arsimit.

PSAK 2017-2021 përmban 7 objektiva strategjike. Për nevoja të këtij studimi është shkoqitur objektivi i parë që përqendrohet te rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar. Brenda këtij objektivi, përqendrimi është vënë në aktivitetet e rezultateve të pritura 4, 5, 6 dhe 8, të cilat ndërlidhen me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në dy tabelat më poshtë janë përmbledhur aktivitetet, rezultatet e pritura dhe objektivat në kuadër të këtyre dy strategjive, që janë të lidhura me objektin e këtij studimi. Dy strategjitë kanë mbivendosje në disa aktivitete, dhe kjo është e kuptueshme.

---

3 [https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA\\_PER\\_PERFSHIRJEN\\_E\\_KOMUNITETEVE\\_ROM\\_DHE\\_ASHKALI\\_NE\\_SHOQERINE\\_KOSOVARE\\_2017-2021.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA_PER_PERFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NE_SHOQERINE_KOSOVARE_2017-2021.pdf)

4 [https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf)



STRATEGJIA PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI  
NË SHOQËRINË KOSOVARE 2017-2021

## FUSHA: ARSIMI

Objektivi strategjik	Rezultatet e pritshme	Aktivitetet
Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali	<b>Rezultati 1.1:</b> Përmirësohet pjesëmarrja në arsim e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.	1.1.1 Stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor
		1.1.2 Hartimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat
		1.1.3 Masa stimuluese për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm të lartë.
		1.1.4 Hartimi i planeve individuale për nxënësit e riadhesuar rom dhe ashkali.
		1.1.5 Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali.
		1.1.6 Mbështetja e programeve për arsimimin e të rriturve.
	<b>Rezultati 1.2:</b> Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali	1.2.1 Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për SMIA.
		1.2.2 Eliminimi i segregacionit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali.
		1.2.3 Mbështetja e qendrave mësimore me bazë në komunitet.
		1.2.4 Ofrimi i mësimi plotësues për nxënësit që ngecin në mësim.
		1.2.5 Promovimi i mësimi të gjuhës rome.
	<b>Rezultati 1.3:</b> Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.	1.3.1 Zhvillimi i programeve për vetëdijesimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme.
		1.3.2 Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkolimit, me fokus të veçantë tek vajzat.
		1.3.3 Vetëdijesimi i popullatës për arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali

PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021

Objektivi strategjik 1	Rezultati	Aktivitetet
<p>Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.</p>	<p><b>Rezultati 1.4</b> Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë për 20%</p>	<p>1.4.1 Harmonizimi i programeve të qendrave mësimore.</p> <hr/> <p>1.4.2 Hartimi i rregulloreve nga komunat për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor dhe arsimin të mesëm.</p> <hr/> <p>1.4.3 Monitorimi i zbatimit të masave lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve në nivelin parashkollor dhe në shkolla të mesme të larta.</p> <hr/> <p>1.4.4. Trajnimi i mësimitdhënësve për mësimitdhënien e gjuhës rome.</p> <hr/> <p>1.4.5 Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat.</p>
	<p><b>Rezultati 1.5:</b> Përfshihen të gjithë fëmijët e riatdhesuar në sistemin arsimor dhe fuqizohen mekanizmat për organizimin e mësimin në diasporë</p>	<p>1.5.1 Monitorimi i zbatimit të legjislacionit për të riatdhesuarit nga grupi mbikëqyrësi i MASHT-it.</p> <hr/> <p>1.5.2 Hartimi i planeve individuale për nxënësit e riatdhesuar.</p> <hr/> <p>1.5.3 Rishikimi i programit për të riatdhesuarit.</p> <hr/> <p>1.5.4 Trajnimi i mësimitdhënësve dhe zyrtarëve komunalë për programin për të riatdhesuarit.</p> <hr/> <p>1.5.5 Koordinimi dhe monitorimi i mësimin plotësues nga grupi mbikëqyrës i MASHT-it</p> <hr/> <p>1.5.6 Organizimi i aktiviteteve për nxënësit e diasporës.</p>

## PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021

**Objektivi strategjik 1****Rezultati****Aktivitetet**

Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.

**Rezultati 1.6:**

Ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalim e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar

1.6.1. Ngritja e kapaciteteve të ekipeve parandaluese në nivel shkollë, komune dhe në nivelin qendror

1.6.2. Rishikimi i rolit të EPRBM

1.6.3. Përmirësimi i grumbullimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë për braktisje dhe mosregjistrim

1.6.4. Krijimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat

1.6.5. Vetëdijësimi i popullatës për arsimimin e kategorive tjera të rrezikuara

1.6.6. Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të arritur në zbatim të politikave që adresojnë braktisjen dhe mosregjistrimin, si dhe paralajmërimin e hershëm për fëmijët në rrezik të braktisjes

1.6.7. Organizimi i mësimit të përsheptuar për nxënësit që kanë braktisur ose nuk janë regjistruar në shkollë

**Rezultati 1.8:**

Ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor

1.8.1 Zhvillohet strategji për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve

1.8.2 Rishikimi i dispozitave për mësimdhënien e gjuhëve

1.8.3 Masat për përmirësimin e mësimdhënies së gjuhës shqipe si gjuhë e dytë

1.8.4 Zhvillimi i moduleve arsimore specifike për komunitete

1.8.5 Zhvillimi i një politike për organizimin e mësimdhënies për diversitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve për të gjithë nxënësit

Mbi bazën e këtyre pjesëve të shkëputura nga këto strategji, janë identifikuar tema të veçanta që janë bërë pjesë e këtij studimi. Pra, studimi është strukturuar nëpër tema të veçanta dhe për këto tema janë kërkuar të dhëna cilësore, të cilat janë mbështetur edhe me të dhëna sasiore, kudo që ka qenë e mundur. Njëkohësisht janë identifikuar palët që mund të shërbejnë si burime informatash.

Për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar pyetësorët e shkurtër me pyetje të hapura, ku palëve u është kërkuar të japin kontributet e tyre përmes informatave të dorës së parë. Varësisht nga nevoja, pyetësorët janë plotësuar me intervista me ato palë për të qartësuar ndonjë aspekt të studimit dhe për të nxjerrë informata më të thella. Në disa raste, disa palëve u është dërguar pyetësori për orientim dhe mbi bazën e tij është realizuar menjëherë intervista me atë palë. Kjo është bërë në varësi të asaj se si vetë pala e ka parë më të përshtatshme. Instrumentet e hulumtimit janë përgatitur si të veçanta për palët e ndryshme, duke përfshirë temat për të cilat janë pritur informata nga ato palë.

## KUFIZIMET E STUDIMIT

Mungesa e madhe e informatave të nevojshme është kufizimi kryesor i këtij studimi. Prej 11 komunave me më shumë banorë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, vetëm 3 komuna e kanë plotësuar pyetësorin me pyetje të hapura, të përgatitur në kuadër të studimit. Fakti se mbledhja e të dhënave u bë gjatë muajit tetor, kur ishte koha e fushatës zgjedhore, në asnjë mënyrë nuk e justifikon këtë sjellje të shumicës së drejtorive komunale të arsimit, përkundrazi. Edhe disa palë të tjera institucionale e joinstitucionale nuk janë përgjegjur në kërkesat për informata për nevoja të studimit.

Ka mungesa të theksuara të të dhënave për aspekte të ndryshme të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sidomos sa i përket ndarjes sipas përkatësisë etnike. Përveç kësaj, gjatë shqyrtimit të të dhënave nga statistikat arsimore është hasur në shumë gabime në të dhëna. Këto mungesa dhe anomali në të dhëna statistikore e kanë ulur besueshmërinë në to, dhe ky është kufizimi tjetër i këtij studimi.

# KONTEKSTI I STUDIMIT

## QASJA E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT

E drejta në arsimim është e drejtë themelore e njeriut. Duke qenë e tillë, ajo është universale. Do të thotë se të gjithë njerëzit pa dallim mbi çfarëdo baze, janë titullarë të kësaj të drejte. Për më tepër, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut si instrumenti më fundamental i të drejtave të njeriut, e proklamoi të drejtën e secilit në arsimim themelor falas<sup>5</sup>. Në frymën e kësaj Deklarate, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës në nenin 28 i obligon shtetet palë, ndër të tjera, që të:

- bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë
- u sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;
- marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës<sup>6</sup>.

Nenin 29 i Konventës, ndërkohë, udhëzon që synimi i arsimit duhet të jetë, ndër të tjera, që të:

- zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
- përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone<sup>7</sup>.

E drejta në arsimim përmbushet vetëm nëse arsimi që ofrohet është cilësor. Pra, ashtu siç proklamohet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, duhet të sigurohet arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i barabartë dhe promovim i mundësive të të nxëniet gjatë jetës për të gjithë<sup>8</sup>.

5 <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20e%20Njeriut%20%281948%29.pdf>

6 <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

7 Po aty

8 [https://www.undp.org/sustainable-development-goals?utm\\_source=EN&utm\\_medium=GSR&utm\\_content=US\\_UNDP\\_PaidSearch\\_Brand\\_English&utm\\_campaign=CENTRAL&c\\_src=CENTRAL&c\\_src2=GSR&gclid=Cj0KCQiAkNiMBhCxARIsAIDDKNVUBucU4mGGE-uej0c97RirupLMNWgEMSBg9eY7\\_vozYrL253E0LtTQaAkzIEALw\\_wcB](https://www.undp.org/sustainable-development-goals?utm_source=EN&utm_medium=GSR&utm_content=US_UNDP_PaidSearch_Brand_English&utm_campaign=CENTRAL&c_src=CENTRAL&c_src2=GSR&gclid=Cj0KCQiAkNiMBhCxARIsAIDDKNVUBucU4mGGE-uej0c97RirupLMNWgEMSBg9eY7_vozYrL253E0LtTQaAkzIEALw_wcB)

Nga këtu, vërehet se është tejet e rëndësishme që të gjithëve t'u ofrohet në mënyrë barabartë arsimim cilësor, duke pasur parasysh nevojat specifike individuale e të grupeve që u përkasin, në mënyrë që t'u mundësohet zhvillimi maksimal i potencialit personal e social.

Ofrimi i barabartë i shërbimeve arsimore, megjithatë, nuk siguron drejtësinë. Trajtimi i barabartë jo doemos është edhe trajtim i drejtë. Duke pasur parasysh grupet shoqërore të cënueshme, instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kanë shkuar një hap më tej në adresimin e nevojave specifike të këtyre grupeve, në mënyrë që të ofrohet trajtimi i drejtë. Kështu, sipas konventës kuadër (kornizë) të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, shtetet duhet të sigurojnë barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Kjo sigurohet përmes masave të nevojshme dhe të përshtatshme, që për pikënisje kanë kushtet e veçanta të personave që u përkasin pakicave kombëtare<sup>9</sup>.

Kosova është e përcaktuar si shoqëri shumetnike që qeveriset në mënyrë demokratike, duke u bazuar në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre<sup>10</sup>. *Kapitulli II i Kushtetutës - Të drejtat dhe liritë themelore*, sqaron se “Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato<sup>11</sup>. Ndërsa në *Kapitullin III – Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre*, shteti merr përgjegjësinë që “...sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore...”.<sup>12</sup>

## KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN SI GRUP I CËNUESHËM NË ARSIM

Ekzistojnë grupe të ndryshme shoqërore që për shkak të karakteristikave të tyre, tradicionalisht kanë qenë subjekte të shtypjes. Këto grupe e kanë përvojën e të jetuarit në margjina të shoqërisë, duke qenë sistematikisht të përjashtuar nga pjesëmarrja e plotë në shoqëri. Si të tilla, këto grupe nuk e kanë potencialin që vetë ta përmirësojnë situatën e tyre jetësore, prandaj kanë nevojë për masa të posaçme afirmative, në mënyrë që t'i gëzojnë të drejtat e tyre të njeriut në mënyrë të barabartë dhe efektive.

Barazia e gjithë qytetarëve, pavarësisht prejardhjes së tyre është i proklamuar si parimi themelor shoqëror. Ajo bazohet në besimin se të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësi të njëjta për të qenë të suksesshëm dhe të kenë jetë produktive dhe të këndshme. Ndërsa barazia si parim dhe si qasje qeverisëse është e përqafuar gjerësisht,


9 Neni 4 i Konventës <https://rm.coe.int/16800c131a>

10 Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

11 Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

12 Neni 58 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

së voni diskutohet shumë për faktin nëse ajo është e mjaftueshme për të trajtuar të gjithë njerëzit si duhet. Ka një debat nëse barazia mjafton apo nëse drejtësia është një parim më i rëndësishëm. Ndonëse shpesh barazia dhe drejtësia përdoren si terma të këmbyeshem, kanë dallim në efektin që e krijojnë në jetën e njerëzve. Drejtësia si parim e pranon se të gjithë nuk e kanë pikënisjen në të njëjtin vend në shoqëri. Disa njerëz apo disa grupe ballafaqohen me kushte e rrethana të rënda, që ua bëjnë atyre të vështirë që me përpjekje të njëjtë të arrijnë qëllimet e njëjta. Këto grupe historikisht kanë qenë në disavantazh, gjë që e bën të vështirë për pjesëtarët e këtyre grupeve të jenë të suksesshëm.



Marrë dhe përshtatur nga: #the4thBox Cut-out Edition, Interaction Institute for Social Change<sup>13</sup>

Prandaj, nuk mjafton që grupeve të cënueshme t'u ofrohet trajtim i barabartë (foto 1). Atyre duhet t'u ofrohet një trajtim i drejtë (foto 2) në këndvështrim të plotësimin të nevojave specifike që i kanë në krahasim me popullatën në përgjithësi. Kjo duhet të ndodh derisa në shoqëri të hiqen barrierat strukturore (foto 3), kur masat e veçanta (afirmative) nuk do të jenë të nevojshme më tej.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë tradicionalisht janë ballafaquar me rrethana të rënda jetësore, për shkak të shkallës së ulët të integritimit në shoqëri, përjashtimit social dhe adresimit të pamjaftueshëm të nevojave të tyre. Këto komunitete ballafaqohen me shkallë të lartë të varfërisë, standard të ulët jetese, kushte të rënda banimi e shëndet të dobët<sup>14</sup>.

<sup>13</sup> <https://interactioninstitute.org/the4thbox-cutout/>

<sup>14</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovë [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en) . Po ashtu, OSBE: [https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590_2.pdf)

Për shkak të këtyre rrethanave, fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian pikënisjen në zhvillimin e përgjithshëm dhe veçanërisht në arsimim nuk e kanë të njëjtë sikur fëmijët e komunitetit shumicë. Kjo, që në moshë të hershme i sjell ata në pozitë jo të barabartë me moshatarët e tyre dhe kjo pabarazi i përcjell në fazat e mëtejshme të zhvillimit e arsimimit. Zhvillimi optimal në fëmijërinë e hershme ndodh vetëm në një mjedis stimules, ku krahas sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve, kërkohet edhe qasje në edukim cilësor në fëmijërinë e hershme, qasje në libra e materiale të të nxëniet, dhe ndërveprim me të rritur që ofrojnë kujdes me përgjegjësi dhe vëmendje të duhur. Një mjedis i tillë zakonisht nuk u sigurohet fëmijëve të këtyre komuniteteve, prandaj shfaqen pabarazitë në zhvillimin e këtyre fëmijëve në krahasim me moshatarët e popullatës shumicë. MICS – Anketa e treguesve të shumëfishtë në Kosovë dhe anketa e treguesve të shumëfishtë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2019/2020<sup>15</sup> ofron të dhëna që dëshmojnë situatën e palakmueshme të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me treguesit e përmendur më sipër, në krahasim me popullatën e përgjithshme.

Politikat arsimore në Kosovë promovojnë një varg masash specifike që u ndihmojnë pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të shtojnë arritjet arsimore, si rrugë për të zvogëluar hendekun në mes tyre dhe popullatës së përgjithshme, të krijuar nga situata specifike e tyre si pjesëtarë të këtyre komuniteteve.

---

15 <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1936/file/MICS%20Snapshots%20.pdf>



MICS: Tregues të zhvillimit në fëmijërinë e hershme

**Treguesi**

**Popullata e përgjithshme**

**Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

**Fëmijët 3-4 vjeç që kanë ndjekur programe të edukimit në fëmijërinë e hershme**

**15%**

**8%**

**Fëmijët 2-4 vjeç me të cilët ndonjë anëtar i rritur i familjes, brenda tri ditëve të fundit para anketës, është përfshirë në aktivitete që promovon të nxënit apo përgatitjen për shkollë**

**63%**

**37%**

**Fëmijët 3-4 vjeç që kanë ndjekur programe të edukimit në fëmijërinë e hershme**

**27%**

**4%**

# ZHVILLIMET NË FUSHËN E ARSIMIMIT TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DH EGJIPTIAN

Dy politikat kryesore që kanë treguar rrugën në fushën e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Kosovë 2017-2021 dhe plani strategjik i arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021. Shumë nga masat e planifikuara brenda këtyre dokumenteve strategjike është dashur të implementohen në nivelin lokal. Megjithatë, rregullisht këto masa janë lidhur me nivelin qendror në këndvështrim të koordinimit dhe/apo mbikëqyrjes nga institucionet qendrore.


Që nga themelimi i institucioneve tona, kapaciteti institucional si në aspektin e burimeve njerëzore ashtu edhe të burimeve financiare ka qenë i mangët. Kjo është vërejtur në masë edhe gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare. Derisa në disa tema që lidhen me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ka pasur qasje aktive të institucioneve dhe udhëheqje kompetente të proceseve, në të tjera tema institucionet kanë pritur nisma nga jashtë. Në këto raste, organizatat donatore e agjencitë zhvillimore ndërkombëtare e kanë marrë rolin udhëheqës përmes projekteve e programeve që kanë qenë në harmoni me politikat arsimore në këtë fushë. Organizatat joqeveritare që punojnë në fushën e arsimit dhe sidomos ato që janë të angazhuara në fushën e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, po ashtu kanë qenë aktive gjatë kësaj periudhe në projekte që për synim kanë pasur përmirësimin e aspekteve të ndryshme të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

## STIMULIMI DHE LEHTËSIMI I REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË NIVELEVE TË NDRYSHME TË ARSIMIT

Regjistrimi dhe vijimi i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e ndryshme të arsimit mbetet tejet i ulët, krahasuar me mesataren e përgjithshme. Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2019/20<sup>16</sup> për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian na ofron të dhëna për dallimin e madh në vijueshmëri të fëmijëve të këtyre komuniteteve në arsim krahasuar me popullatën e përgjithshme. Derisa 84% e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të moshës së shkollës fillore e ndjekin shkollën fillore, vetëm 2/3 e fëmijëve të këtyre komuniteteve të moshës së arsimit të mesëm të ulët e ndjekin këtë nivel të arsimit, e më tutje vetëm 1/3 e këtyre fëmijëve e vijnë shkollën e mesme të lartë. Vijueshmëria në edukimin në fëmijërinë e hershme është tejet e ulët edhe në nivel vendi me vetëm 15% të fëmijëve të moshës 35 – 59 muaj që ndjekin edukimin parashkollor. Ndërsa, edhe me keq, vetëm 8% e fëmijët rom, ashkali dhe egjiptianë të kësaj moshe janë të sistemuar në institucione të edukimit parashkollor.

16 <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1936/file/MICS%20Snapshots%20.pdf>

MICS 2019/20: Shkalla e vijueshmërisë së shkollimit



Shkalla e ulët e përfshirjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian sidomos në edukimin parashkollor dhe arsimin e mesëm të lartë arsyeton parashikimin e masave për stimulimin dhe lehtësimin e regjistrimit dhe vijueshmërisë në edukimin parashkollor dhe arsimin e mesëm të lartë.

## VETËDIJESIMI PËR RËNDËSINË E REGJISTRIMIT ME KOHË DHE VIJIMIN E SHKOLLIMIT

Vetëdija e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e regjistrimit më kohë të fëmijëve të tyre dhe vijimit të rregullt në shkollë është shtuar dukshëm krahasuar me shumë vjet më parë. Sidoqoftë, aktivitetet dhe fushatat vetëdijesuese ende janë masa që stimulojnë dhe lehtësojnë regjistrimin dhe vijimin e këtyre fëmijëve në shkollë.

Fushatat vetëdijesuese organizohen rregullisht në nivel lokal. Në disa komuna, këto fushata planifikohen e organizohen në bashkëpunim në mes të komunave dhe OJQ-ve që punojnë në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por në shumicën e komunave janë OJQ-të bartëse të këtyre fushatave, ndërsa komunat herë ofrojnë ndonjë mbështetje (p.sh me informata nga regjistri i të lindurve, etj.), e herë nuk marrin pjesë në to në ndonjë mënyrë. OJQ-të janë treguar shumë efektive në organizimin e këtyre fushatave. Që në maj apo qershor fillon identifikimi i të gjithë fëmijëve të këtyre komuniteteve që duhet të regjistrohen në shkollë dhe fillon fushata e informimit dhe vetëdijesimit. Në shënjestër të kësaj fushate janë familjet, ndërsa ajo organizohet përmes sesioneve informative, shpërndarjes së fletëpalosjeve, prodhimit dhe publikimit të spoteve ndërgjegjësuese, organizimit të ngjarjeve publike, e deri te vizitat derë më derë nëpër familje. Rol të madh këtu luajnë ndërmjetësuesit në komunitet që e njohin mirë komunitetin e tyre dhe kanë njohuri e shkathtësi për të ndërmjetësuar mes komunitetit dhe institucioneve.

Një shembull i mirë është raportuar nga Gjakova, ku që disa vjet organizatat e ndryshme janë bashkuar edhe me aktivistët e tjerë e me institucionet, dhe e bëjnë këtë fushatë si të përbashkët, nën ombrellën e Grupit Këshillues për Komunitete, që është grup joformal, por që është treguar shumë efektiv në këtë dhe në çështje të tjera që lidhen me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

## LEHTËSIMI I REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË FËMIJËVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË NIVELIN PARASHKOLLOR DHE ARSIMIN E MESËM

PSAK 2017-202121 parasheh hartimin e rregulloreve nga komunat për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor dhe arsimin e mesëm. Vetëm komuna e Obiliqit e ka hartuar një rregullore të këtillë. Projekti i përbashkët i BE dhe KiE “INCLUDE – Ndërtimi i kapaciteteve për gjithëpërfshirje në arsim”<sup>17</sup> i cili është në zbatim, ndër të tjera do të ndihmojë disa komuna që të krijojnë kapacitetet për të ulur barrierat ekzistuese në regjistrimin në arsim të komuniteteve rom, ashkali

17 <https://pjp-eu.coe.int/en/web/building-capacity-for-inclusion-in-education/home>

dhe egjiptian dhe fëmijëve me nevoja të veçanta. Nga divizioni për arsimin e komuniteteve në MASHTI, që bashkëpunon me këtë projekt, shpresojnë se këto komuna do të përfitojnë edhe lidhur me rregulloret e këtilla.

Lidhur me edukimin parashkollor, ka komuna që ndonëse nuk i kanë këto rregullore, mundohen që të lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa komunat e tjera deklarojnë se bëjnë trajtim të barabartë sipas kritereve dhe rregulloreve të IAP-ve. Nuk ka informata, ndërkaq, që MASH-TI e ka rregulluar ose ka udhëzuar në ndonjë mënyrë lehtësimin e regjistrimit në edukimin parashkollor. UA 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë<sup>18</sup> parasheh lirim nga pagesa për fëmijët nga grupet e rrezikuara, duke specifikuar disa grupe të këtilla, por pa i përfshirë si grup të tillë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Disa organizata që menaxhojnë qendra mësimore në kuadër të programeve të qendrave mësimore kanë ofruar dhe ofrojnë programe të edukimit në fëmijërinë e hershme, përfitues të të cilave janë kryesisht fëmijët e këtyre komuniteteve. Megjithatë, këto programe nuk janë të vazhdueshme, pasi varen nga fondet në dispozicion brenda projekteve që implementojnë. Në raste, janë raportuar bashkëpunime më të qëndrueshme në mes të këtyre organizatave dhe komunave, kur komunat marrin përsipër pagat e edukatorëve, sikurse është shembulli i bashkëpunimit në mes të Caritasit zviceran në Kosovë dhe komunës së Gjakovës dhe komunës së Prizrenit.

Lidhur me lehtësimin e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë, komunat rregullisht i ndërmarrin këto masa duke rezervuar në secilën shkollë të mesme të lartë së paku 5 vende për regjistrim të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që nuk kanë arritur të regjistrohen sipas kritereve të pranimit. Në këtë drejtim, ka kontribuar një vendim ministror lidhur me rezervimin e këtyre vendeve.

Nuk është arritur të provohet se ekziston një proces i monitorimit të zbatimit të masave lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve në nivelin parashkollor dhe në shkolla të mesme të larta.

## STIMULIMI PËRMES SISTEMIT TË BURSIVE DHE MENTORIMIT

Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme të larta stimulohen të vijojnë dhe përfundojnë këtë nivel të shkollimit edhe përmes ofrimit të bursave. MASHT, me ndihmën e organizatave donatore prej vitit 2014 ka ofruar bursa për këta nxënës. Në vitin 2016, projektet që ofronin bursa, e që ishin të financuara nga BE, HEKS/EPER dhe REF u bashkuan nën koordinimin e MASHT për të unifikuar sistemin e ofrimit të bursave. Pjesë e financimit në vitet më pas ishte edhe GIZ. Kështu, projekti i BE-së EU-SIMRAES 2 angazhoi një ekspert për të lehtësuar procesin e hartimit të kritereve të përbashkëta për përfituesit e bursave për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Prej atëherë, thirrja për bursa ishte e përbashkët dhe të gjithë nxënësit aplikonin në MASHT. Palët që ofronin bursa, pastaj merrnin numrin a caktuar të bursistëve për t'i përkrahur. Më tutje, projekti EU-SIMRAES 2 financoi edhe disenjimin e një baze të të dhënave të bazuar në ueb, e cila shërben për menaxhimin e informatave të bursistëve. Secila organizatë ofruese e bursave dhe vetë MASHT kishin llogari përdoruesish dhe të dhënat futeshin e përpunoheshin në kohë reale. Fatkeqësisht, pas

<sup>18</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/19-ua-nr-19-2016-per-perfshirjen-e-femijeve-ne-institucionet-parashkollore-ne-kosove-rotated.pdf>

përfundimit të projektit EU-SIMRAES 2, MASHT nuk arriti ta marrë në menaxhim bazën e të dhënave për ta vazhduar përdorimit. Raportohet se dy vitet e fundit përdoret një bazë e të dhënave në Excel.

Prej vitit 2016/17 nga programi i bursave kanë përfituar çdo vit 500-600 nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Lartësia e bursës për një nxënës, për një vit ka qenë 300 Euro.

Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme të larta, aplikues dhe përfitues të bursave					
2016/17	Aplikues	686	2019/20	Aplikues	812
	Përfitues	501		Përfitues	500
2017/18	Aplikues	724	2020/21	Aplikues	700
	Përfitues	507		Përfitues	585
2018/19	Aplikues	785	2021/22	Aplikues	N/A
	Përfitues	601		Përfitues	N/A

Në vitin aktual shkollor 2021/22, MASHTI si i vetëm e ka përgatitur procesin e bursave. Është arritur të sigurohen fondet për ndarjen e 500 bursave. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, ka qenë në vijim procesi i aplikimit për bursa për vitin shkollor 2021/22, prandaj nuk ka informata për numrin e aplikuesve dhe të përfituesve për këtë vit.

Prej vitit 2016/17, për tri vite me radhë, së paku gjysma e nxënësve përfitues të bursave, kanë përfituar edhe nga programi i mentorimit. Për të ngritur kapacitetet e mentorimit, EU-SIMRAES 2 dhe REF kanë trajnuar dhe certifikuar si mentorë, së paku 50 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta. Këta mësimdhënës janë angazhuar me nxënësit dhe familjet e tyre në mbështetje përmes mentorimit, në mënyrë që të shtohen arritjet mësimore të këtyre nxënësve. Nga divizioni për arsim të komuniteteve në MASHTI na është thënë se nuk dihet nëse MASHTI mund ta vazhdojë procesin e mentorimit.

## LEHTËSIMI I REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË STUDENTËVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË ARSIMIN E LARTË

Për të lehtësuar regjistrimin e studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e lartë, Qeveria ka nxjerrë UA 09/2016<sup>19</sup> për aplikimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë. Ky UA përcakton për secilën njësi akademike kuotën prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komunitetet joshumicë, që do të shpërndahet në bazë të kandidatëve të regjistruar nga komunitetet joshumicë, deri në përmbushjen e kuotës. Raportohet se në përgjithësi kjo kuotë e vendeve të rezervuara respektohet nga njësitë akademike të universiteteve publike. Megjithatë, OShC-të shprehin dyshime për raste të keqpërdorimit të kësaj kuote nga studentët e komunitetit shumicë, pasi përveç vetëdeklarimit të studentit për përkatësinë etnike me rastin e aplikimit për regjistrim, UA nuk u kërkon institucioneve publike të arsimit të lartë (IAL) të bëjnë tjetër vërtetim mbi përkatësinë etnike. Ndonëse, në formularin për vetëdeklarim ceket neni për deklarimin e rrejtshëm sipas Kodit Penal i Republikës së Kosovës, raste të deklarimit të rrejtshëm mund të ndodhin dhe ato mund të kalojnë të pavërejtura. Mbështetja e studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me bursa është një formë tjetër e lehtësimit të vijimit dhe përfundimit të studimeve. UA 09/2016 cek se studentët e komuniteteve shumicë dhe komuniteteve joshumicë janë përfitues të skemave të mbështetjes financiare me bursa, në bazë të legjislacionit në fuqi, por nuk ka ndonjë pikë në këtë UA ku u jepet përparësi studentëve të komuniteteve joshumicë që të përfitojnë nga kjo mbështetje financiare me bursa. Ndërsa UA 14/2017 për ndarjen e bursave<sup>20</sup> i përcakton kategoritë e studentëve me përparësi, por në mesin e 7 kategorive të tilla nuk janë të përfshirë studentët nga komunitetet rom ashkali dhe egjiptian. Rrjedhimisht, studentët e këtyre komuniteteve nuk përfitojnë ndonjë lehtësim në thirrjet për bursa që i publikon MASHTI. Për më tepër, nga divizioni për arsim të komuniteteve në MASHTI kemi mësuar se një fond prej 20,000 eurosh në vit ka qenë i dedikuar për bursa për studentët e këtyre komuniteteve, por është dashur që këtë fond ta shkrijnë në fondin e përgjithshëm të bursave, për shkak të mungesës së bazës ligjore për ta administruar ndryshe.

Në anën tjetër raportohet për burime të tjera të mbështetjes financiare me bursa për studentët e komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian. Disa komuna ofrojnë bursa për studentët nga ato komuna. Një praktikë e mirë e lehtësimit të përfitimit nga bursat komunale për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është demonstruar në Gjakovë. Komuna e ka një rregullore për subvencionet në bazë të së cilës bëhet edhe thirrja për bursa. Me nismën e ZKKK dhe në bashkëpunim me DKA, vitin e kaluar është vënë një pikë në kuadër të thirrjes për bursat, ku janë ndarë 5 bursa për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për këto 5 bursa studentët e këtyre komuniteteve kanë konkurruar brenda këtyre komuniteteve.

Projektet e organizatat e ndryshme janë burime të tjera të mbështetjes së studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Nga OShC-të janë marrë informata se REF përmes programit të implementuar nga Roma Versitas Kosovo mbështet studentët rom, ashkali dhe egjiptian në vijimin dhe përfundimin e arsimit të lartë. Përkundër përpjekjeve për të mësuar më shumë rreth kësaj mbështetjeje, nuk është arritur të merren informata nga Roma Versitas Kosovo.

19 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

20 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/ua-masht-14-2017-per-ndarjen-e-bursave.pdf>

## PUNA E QENDRAVE MËSIMORE

### FAZA E HERSHME E QENDRAVE MËSIMORE

Koncepti i qendrave mësimore u shfaq në fillim të viteve 2000. Fillimisht, më mbështetjen financiare të organizatave e agjencive donatore, u hapën qendra të komunitetit në lokalitete ku kishte përqendrim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto qendra ofronin shërbime të ndryshme për pjesëtarët e komunitetit. Me kohë, puna e këtyre qendrave u fokusua më shumë te përkrahja e fëmijëve të këtyre komuniteteve, në aspekt të ndihmës në vijimin e shkollimit dhe në përmirësimin e rezultateve mësimore. Rrjedhimisht, gjithnjë e më shumë konceptoheshin si qendra mësimore, ku fëmijët e këtyre komuniteteve marrin mbështetje shtesë mësimore. Megjithatë, disa QM ofronin shërbime e aktivitete shtesë për fëmijët që vijonin në këto qendra, por edhe për familjet e tyre, si programi i shkrim-leximit për prindërit, aktivitete dhe këshillime për çështje shëndetësore e sociale, fushata vetëdijesimi, etj.

Deri në vitin 2016 numri i qendrave mësimore në Kosovë ishte rreth 40 syresh. Ndikimi pozitiv i qendrave mësimore për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por edhe për fëmijët e tjerë që kishin nevojë për mbështetje mësimore shtesë u vlerësua nga të gjitha palët. Komisioni Evropian në raportet vjetore për Kosovë rregullisht e ka pranuar rolin e qendrave mësimore në uljen e numrit konsiderueshëm të madh të braktisjeve të shkollës dhe në mundësimin e integritit të mëtejshëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit<sup>21</sup>. Një studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore i bërë në vitin 2015<sup>22</sup> nga UBO Consulting, për nevoja të UNICEF, BE dhe KiE, tregon se ndikimi i qendrave mësimore ka qenë pozitiv në: përfshirjen sociale të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; performancën e përmirësuar në shkollë të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian; uljen e braktisjes e kthimin në shkollë të fëmijëve në kushte rruge; dhe reduktimin e ndarjes dhe përjashtimit.

### INSTITUCIONALIZIMI I QENDRAVE MËSIMORE

Qeveria e Kosovës e vuri në planifikimin strategjik për periudhën 2017-2021 ofrimin nga ana e MASHT dhe komunave të mbështetjes për qendrat mësimore, qoftë përmes përkrahjes financiare të OJQ-ve që administrojnë me to, ose përmes ofrimit të hapësirave për punë në objekte publike, sidomos në shkolla. Po ashtu, u planifikua edhe zhvillimi i bazës juridike për institucionalizimin e këtyre qendrave në kuptim të zhvillimit të standardeve të operimit, të planprogrameve dhe të stafit që angazhohet në ato qendra<sup>23</sup>. Rrjedhimisht në këtë cikël 5-vjeçar strategjik të arsimit, kishte zhvillime të mjaftueshme në këtë drejtim. Fillimisht, pati një mobilizim të OShC-ve për të koordinuar përpjekjet për institucionalizimin e qendrave mësimore. Këto përpjekje u mbështetën edhe nga organizatat e agjencitë donatore, të cilat që një kohë kishin kërkuar që institucionet të merrnin përsipër financimin dhe mbështetjen tjetër të qendrave mësimore. Reagimi nga MASHT ishte pozitiv. Me mbështetjen e projektit KOSINT 2020, MASHT-i e koordinoi procesin me pjesëmarrje për hartimin e UA

21 Raporti për Kosovë 2016 i Komisionit Evropian: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2018-12/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2018-12/20161109_report_kosovo.pdf)

22 [http://uboconsulting.com/PDF/al/Study\\_on\\_Impact\\_and\\_Sustainability\\_of\\_the\\_Learning\\_Centers-ALB.PDF](http://uboconsulting.com/PDF/al/Study_on_Impact_and_Sustainability_of_the_Learning_Centers-ALB.PDF)

23 Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 [https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA\\_PER\\_PERFSHIRJEN\\_E\\_KOMUNITETEVE\\_ROM\\_DHE\\_ASHKALI\\_NE\\_SHOQERINE\\_KOSOVA-RE\\_2017-2021.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA_PER_PERFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NE_SHOQERINE_KOSOVA-RE_2017-2021.pdf)



për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore. Rezultat i këtij procesi ishte miratimi i UA 19/2018<sup>24</sup>. Për të lehtësuar zbatimin e UA, procesi vazhdoi me hartimin e një udhëzuesit për zbatimin e këtij UA<sup>25</sup>. Edhe ky udhëzues u hartua në një proces me pjesëmarrje, i cili u koordinua nga MASHT-i dhe u mbështet nga GIZ.

Bazuar në UA 19/2018 dhe udhëzuesin për zbatim të tij, prej qershorit 2020 është shpallur thirrja për aplikim për regjistrimin e qendrave mësimore. Nga divizioni për arsim të komuniteteve janë ofruar informatat se deri në nëntor 2021 janë 40 qendra mësimore që kanë aplikuar për regjistrim. Prej tyre, 16 QM janë regjistruar, 4 janë në proces të marrjes së vendimit, ndërsa 20 janë në proces të shqyrtimit nga komisioni.

Më në fund, këtë vit për herë të parë është ndarë një fond publik për financimin e OJQ-ve që menaxhojnë qendra mësimore. Fondi i ndarë është rreth 200,000 euro. Në thirrjen e bërë nga MASHTI kanë përfituar tri organizata që kanë qendra mësimore dhe vlera e përkrahjes financiare për to është gjithsej 97,000 euro. Pjesa tjetër e fondit të ndarë do të bartet për vitin tjetër dhe pritet që ky fond të rritet deri në 400,000 euro.

## PUNA AKTUALE E QENDRAVE MËSIMORE

Ndërkohë, gjatë këtyre viteve të fundit qendrat mësimore kanë funksionuar të menaxhuara nga OJQ-të përmes projekteve të financuara nga organizatat donatore. Vlerësohet të jenë rreth 80 qendra mësimore që operojnë në Kosovë. Puna e qendrave mësimore gjatë kësaj periudhe ka fituar në cilësi, falë harmonizimit të programeve të qendrave me kurrikulën e arsimit parauniversitar, si dhe falë zhvillimit profesional të stafit të qendrave mësimore. Përveç kësaj, organizatat që menaxhojnë qendrat mësimore e kanë inkurajuar stafin që nuk ishte i kualifikuar të vazhdojë arsimin formal dhe të kualifikohet si personel mësimdhënës. Një studim më i ri lidhur me ndikimin e qendrave mësimore në përfshirjen e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, i bërë në vitin 2018<sup>26</sup> nga projekti KOSINT 2020, e tregon perspektivën e prindërve për kontributin e qendrave mësimore, ku spikatet kontributi i qendrave në:

- integrimin më të mirë të fëmijëve;
- komunikimin/shkathhtësitë gjuhësore të përmirësuar;
- socializimin më të madh;
- performancën e përmirësuar shkollore; dhe
- motivimin për të vazhduar arsimin formal.

24 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>

25 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/12/udhezues.pdf>

26 [http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove\\_alb.pdf](http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove_alb.pdf)

Veçanërisht aktive ishin organizatat donatore të cilat përveç ndikimit në përshejtimin e institucionalizimit të qendrave mësimore, ndikuan shumë në koordinimin e ndihmës për qendrat mësimore nga burime të ndryshme. Për ta rritur ndikimin e investimeve nëpër qendra mësimore dhe për ta shmangur dyfishimin a shumëfishimin e investimeve për të njëjtit përfitues, u organizuan takimet periodike koordinuese të komunitetit donator, shpesh me pjesëmarrjen e menaxhmentit të projekteve më të mëdha që ndihmonin qendra mësimore. Pjesëmarrëse në këto takime ishin Zyra e BE, GIZ, ADA, SDC, etj.

Falë bashkëpunimit të shtuar me komunat, shumë qendra mësimore u akomoduan nëpër hapësira shkollore, duke e shtuar numrin e qendrave me bazë në shkollë. Komunat morën përsipër mbulimin e shpenzimeve komunale për punën e qendrave. Madje disa komuna, si Gjakova e Obiliqi, filluan të mbulojnë edhe shpenzimet komunale të qendrave me bazë në komunitet. Disa komuna tashmë kanë gjetur mundësi të marrin përsipër pagat e stafit të QM-ve. Bashkëpunimi u shtua në nivel të menaxhmentit të QM-ve dhe shkollave, si dhe ndërmjet mësimdhënësve të shkollave e fasilitatorëve të QM-ve. Kësisoj, komunat po bëhen gati të bashkëmenaxhojnë ose ta marrin përsipër menaxhimin e qendrave mësimore. Si shembull, nga VoRAE mësohet se kjo organizatë nuk e ka më asnjë QM në menaxhim të drejtpërdrejtë, sepse ato kanë kaluar në menaxhim të komunave. Ndërsa organizata angazhohet në monitorim dhe ngritje të kapaciteteve.

## ADRESIMI I BRAKTISJES

Tradicionalisht shkalla e braktisjes së nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë me e lartë sesa ajo e popullatës së përgjithshme. Një prirje e tillë vërehet edhe në vitet e fundit. Në raportet vjetore statistikore me tregues arsimorë, të dhënat për braktisjen jepen si të përgjithshme, pa i ndarë sipas përkatësisë etnike. Për nevoja të këtij studimi, nga zyra e SMIA janë ofruar të dhënat për braktisjen e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilat janë të paraqitura sipas viteve shkollore në tabelat më poshtë.

Braktisja nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2016/17

Niveli	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Fillor/i mesëm u ulët	40	21	61	4	3	7	19	13	32	63	37	100
I mesëm i lartë	0	0	0	8	11	19	0	0	0	8	11	19
<b>Gjithsej</b>	<b>40</b>	<b>21</b>	<b>61</b>	<b>12</b>	<b>14</b>	<b>26</b>	<b>19</b>	<b>13</b>	<b>32</b>	<b>71</b>	<b>48</b>	<b>119</b>

Braktisja nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2017/18

Niveli	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Fillor/i mesëm u ulët	26	28	54	12	2	14	3	3	6	41	33	74
I mesëm i lartë	0	0	0	2	1	3	11	0	11	13	1	14
<b>Gjithsej</b>	<b>26</b>	<b>28</b>	<b>54</b>	<b>14</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>14</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>54</b>	<b>34</b>	<b>88</b>

Braktisja nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2018/19

Niveli	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Fillor/i mesëm u ulët	27	21	48	5	2	7	12	4	16	44	27	71
I mesëm i lartë	2	1	3	5	0	5	4	0	4	11	1	12
<b>Gjithsej</b>	<b>29</b>	<b>22</b>	<b>51</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>20</b>	<b>55</b>	<b>28</b>	<b>83</b>

Braktisja nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2019/20

Niveli	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Fillor/i mesëm u ulët	12	14	26	0	0	0	9	3	12	21	17	38
I mesëm i lartë	1	1	2	4	3	7	1	2	3	6	6	12
<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>15</b>	<b>28</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>15</b>	<b>27</b>	<b>23</b>	<b>50</b>

Braktisja nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2020/21

Niveli	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Fillor/i mesëm u ulët	27	25	52	3	0	3	6	2	8	36	27	63
I mesëm i lartë	0	0	0	0	0	0	3	1	4	3	1	4
<b>Gjithsej</b>	<b>27</b>	<b>25</b>	<b>52</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>12</b>	<b>39</b>	<b>28</b>	<b>67</b>

Ndërkaq, nga raportet vjetore statistikore janë marrë të dhënat për braktisjen e të gjithë nxënësve dhe është bërë një krahasim. Dallimi është shumë i madh. Në nivelin fillor/të mesëm të ulët, braktisja e të gjithë nxënësve në 5 vitet e fundit sillet mes 0.06% e 0.10%, ndërsa braktisja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian sillet mes 0.65% e 1.85%. Në nivelin e mesëm të lartë braktisja e të gjithë nxënësve në 5 vitet e fundit sillet mes 1.20% e 1.80%, ndërsa braktisja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian sillet mes 0.75% e 2.53%. Norma më e ulët prej 0.75% është raportuar në vitin 2020/21, kur zotëronte pandemia Covid-19. Në kushte të mësimi që kapërcente prej një skenari në tjetrin, ka qenë më e vështirë të përcjelljet vijueshmëria dhe mbajtja në arsim, prandaj, ka dyshime që raportimi ka qenë i mangët.

Braktisja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, krahasuar me braktisjen e përgjithshme, sipas viteve shkollore:

Niveli	2016/17		2017/18		2018/19		2019/20		2020/21	
	Rom Ashkali Egjiptian	Të gjithë	Rom Ashkali Egjiptian	Të gjithë	Rom Ashkali Egjiptian	Të gjithë	Rom Ashkali Egjiptian	Të gjithë	Rom Ashkali Egjiptian	Të gjithë
Fillor, e i mesëm i ulët	1.85	0.06	1.30	0.10	1.23	0.10	0.65	0.10	1.06	N/A
I mesëm i lartë	N/A	1.60	2.53	1.80	2.06	1.80	2.08	1.20	0.75	N/A

Formulimi N/A (nuk është e aplikueshme) në tabelë, te viti 2020/21 nënkupton se të dhënat e braktisjes për këtë vit ende nuk janë në dispozicion pasi nuk është publikuar nga MASHTI raporti vjetor statistikor me tregues arsimorë. Ndërsa te viti 2016/17 është hasur një anomali te numri i nxënësve ashkali në këtë vit, pasi janë raportuar vetëm 2 nxënës ashkali të nivelit të mesëm të lartë. E pabesueshme kur në vitet tjera numri i këtyre nxënësve sillet mes 224 e 261.

Përgjatë viteve ka pasur zhvillime për të rregulluar dhe adresuar braktisjen dhe mosregjistrimin. Disa nga gjërat të bëra në këtë drejtim janë:

- Në vitin 2012 është nxjerrë UA 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaja braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar<sup>27</sup>;
- Në vitin 2014 është publikuar doracaku për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar<sup>28</sup>;
- Në vitin shkollor 2016/17 në kuadër të SMIA është shtuar edhe Moduli i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) i cili gjeneron informacione për rastet që janë në rrezik të braktisjes, të cilat identifikohen dhe raportohen nga shkollat;
- Në vitin 2018 është nxjerrë UA 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaja braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar<sup>29</sup>;

Nga MASHTI kuptohet se në proces është rishikimi i doracakut për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, për ta përshtatur me UA të ri 08/2018. Kur jemi te ky UA, për dallim nga UA paraprak 19/2012, ky UA parasheh themelimin e EPRBM-ve edhe në nivel të shkollave të mesme të larta, pra përtej arsimit të obligueshëm. Po ashtu, ky UA parasheh dispozitat për modulën e Sistemit të paralajmërimit të hershem (SPH) në SMIA.

**Në legjislacionin dhe rregullativën lidhur me reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit nuk gjendet ndonjë udhëzim për trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.**

27 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8222>

28 [https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim_1.pdf)

29 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbm-napu.pdf>

Nga komunat raportohet se EPRBM-të janë themeluar dhe funksionojnë. Nga MASHTI, po ashtu, theksohet se këto ekipe janë themeluar në nivel shkollash dhe në nivel komunash, mirëpo thuhet se jo të gjitha ekipet janë funksionale e operojnë sipas rregullativës, dhe jo të gjitha shkollat janë duke e ndjekur modelin e ofruar të punës. Ndërkaq, edhe në nivel MASHTI është themeluar EPRBM-ja. Sidoqoftë, nuk ka informata për një sistem konsekuent komunikimi në mes të niveleve të ndryshme të EPRBM-ve. Në MASHTI nuk kanë pohuar se është bërë ndonjë monitorim dhe vlerësim i progresit të arritur në zbatim të politikave që adresojnë braktisjen dhe mosregjistrimin, si dhe paralajmërimin e hershëm për fëmijët në rrezik të braktisjes.

Lidhur me modulën e sistemit të paralajmërimin të hershëm, nga MASHTI tregohet se raportimet janë të vogla, por prej kohës kur kanë nisur raportimet e para në këtë modul, vit pas viti janë rritur raportimet. Të dhënat nga SMIA tregojnë se prej vitit 2016/17 kur ka filluar raportimi te moduli SPH në SMIA, gjithsej janë vetëm 6 komuna dhe vetëm 14 shkolla nga këto komuna prej nga janë raportuar raste të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në rrezik të braktisjes. Vetëm nga komuna e Gjakovës janë raportuar raste secilin vit. Janë 5 shkolla të kësaj komune që kanë raportuar raste së paku një vit, derisa shkolla “Mustafa Bakija” këtë e ka bërë çdo vit.

Raportimet në modulën SPH për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Vitet	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21
<b>Raportime</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>29</b>	<b>23</b>	<b>35</b>
	Mustafa Bakija	Mustafa Bakija	Mustafa Bakija	Mustafa Bakija	Mustafa Bakija
		Yll Morina	Yll Morina	Yll Morina	Yll Morina
Gjakova	Zef Lush Marku		Zef Lush Marku		
				Mazllum Këpuska	
				Selman Riza	
Ferizaj	Tefik Çanga	Tefik Çanga	Tefik Çanga		Tefik Çanga
			Ahmet Hoxha		
Prishtina				Emin Duraku	
					Asim Vokshi
Prizreni			Lekë Dukagjini		
			Mati Logoreci		
			Ibrahim Fehmiu		
Fushë Kosova			Selman Riza		
Kamenica	Idriz Seferi				

Në përputhje me të dhënat më sipër janë edhe informatat që janë marrë nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Gjakovë, me të cilat dëshkohet se EPRBM-ja në nivel komune është tejet aktive, duke u takuar çdo vit me të gjitha EPRBM-të shkollore dhe duke adresuar rastet të cilat nuk kanë mundur të adresohen me sukses në nivel shkolle.

ivizioni i arsimit të përgjithshëm në MASHTI thekson se planet e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit ekzistojnë në të gjitha komunat, por nuk ofrohet ndonjë dëshmi për këtë. Ndërsa, prej tri komunave që kanë ofruar të dhëna për këtë studim, komuna e Fushë Kosovës deklaroi se ekziston plani i veprimit, ndërsa në Gjakovë dhe Podujevë jo. Megjithatë, nga DKA-të deklarohet se rastet e braktisjes dhe mosregjistrimit trajtohen sipas rregullave dhe trajtimi bëhet i njëjtë pavarësisht se për cilët nxënës bëhet fjalë. Ndërkohë, lidhur me efikasitetin e EPRBM-ve në shkolla, ato deklarojnë se këto ekipe nuk kanë mbështetje financiare dhe punojnë vullnetarisht, jashtë punëve të rregullta që i kanë.

Komunat e pranojnë rolin e madh të OShC-ve në adresimin e rasteve të braktisjes dhe mosregjistrimit. Këto organizata me përkrahjen e projekteve të ndryshme kanë krijuar një sistem efektiv të identifikimit të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të braktisur ose të paregjistruar dhe angazhohen me shkollat e familjet në regjistrimin apo kthimin e tyre në shkollë. Këto organizata e kanë edhe përparësinë e njohjes së mirë të komunitetit duke qenë se shumica prej tyre janë organizata komunitare. Vetë OShC-të e vërtetojnë këtë gjë.

**EPRBM-të në shumicën e rasteve nuk janë funksionale. Problemi fillon me mësimdhënësit të cilët nuk dërgojnë informata me kohë te drejtori i shkollës apo ekipi. Ata reagojnë vetëm kur fëmija i bën 100-200 mungesa. Edhe në këto raste zakonisht nuk ka vizita në terren, pos kur ne organizatat e ftojmë EPRBM-në për të bërë vizitë në familje. Organizatat në këto raste janë të detyruara të vazhdojnë me kontakte dhe komunikime të shpeshta me prindërit dhe fëmijët për t'i bindur të kthehen në bankat shkollore. (OShC nga Prizreni)**

Kjo gjë, po ashtu, vërtetohet nga një raport vlerësues mbi efektivitetin e EPRBM-ve, që fokusohet në efektivitetin e EPRBM-ve të fëmijët romë, ashkali dhe egjiptian<sup>30</sup>, i publikuar në vitin 2019 në kuadër të KOSINT 2020. Ky raport e thekson rolin e OShC-ve dhe aktivitetet që i zhvillojnë në këtë drejtim:

- OShC-të kanë rol kyç në identifikimin e fëmijëve të paregjistruar në shkollë. Sidomos ato organizata të cilat aktivitetin e tyre e kanë përqendruar në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Disa organizata praktikojnë që me anë të aktiviteve të tyre në komunitet të identifikojnë fëmijët të cilët janë në moshë të vijimit të shkollimit, mirëpo nuk janë të regjistruar në shkollë. Më tutje fëmijët të cilët nuk figurojnë në listat e nxënësve të regjistruar në shkollë asistohen nga këto organizata për t'u regjistruar;

30 [http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raport\\_i\\_fokusuar\\_ne\\_efektivitetin\\_e\\_eprbm-ve\\_te\\_femijet\\_rome\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptian-1\\_ALB.pdf](http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raport_i_fokusuar_ne_efektivitetin_e_eprbm-ve_te_femijet_rome_ashkali_dhe_egjiptian-1_ALB.pdf)

- Për adresim të rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian shpesh praktikohet që rasti të referohet te ndërmjetësuesi në komunitet.

Raporti në fjalë dëshmon edhe lidhur me raste të trajtimit joserioz nga ana e shkollave të rasteve të braktisjes ose mosregjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe tregon pasojat e mëtutjeshme nga ky trajtim joserioz. Janë dy këso rastesh:

- Rastet e braktisjes së shkollimit, e sidomos të nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, që zakonisht evidentohen në administratën e shkollës si nxënës të panotuar dhe nuk regjistrohen në SPH. Po ashtu, ndodh që rastet e braktisjes së shkollimit nuk raportohen me kohë. Kjo ndikon që rastet e tilla të humbin një vit shkollor për shkak të mungesës relativisht të gjatë në shkollë dhe mungesës së ofrimit të mësimi të përsheptuar.
- Rastet e mosregjistrimit në klasë të parë nuk regjistrohen në SPH. Ndonjëherë shkolla nuk ka informata për këta fëmijë të cilët e kanë arritur moshën për regjistrim në klasë të parë por nuk paraqiten në shkollë për t'u regjistruar. Ndonjëherë, nxënësit të cilët fillojnë klasën e parë, e braktisin shkollimin qysh në fillim të klasës së parë. Ata nuk konsiderohen si braktisës të shkollimit por si fëmijë që duhet të presin një vit për të arritur pjekurinë psiko-fizike. Rrjedhimisht, këta nxënës nuk raportohen si braktisës të shkollimit dhe rastet e tyre nuk regjistrohen në SPH.

Të dyja këto raste të trajtimit joserioz, përveç që i dëmtojnë fëmijët duke ua humbur një vit shkollor, më tutje i rrisin gjasat që mosregjistrimi apo braktisja e këtyre nxënësve të përsëritet për shkak të adaptimit të vështirë me gjeneratat pasuese të shokëve e shoqeve.

Edhe pse PSAK parasheh organizimin e mësimi të përsheptuar për nxënësit që kanë braktisur ose nuk janë regjistruar në shkollë, nuk ka dëshmi të organizimit të mësimi të tillë. Është raportuar se vite më parë një mësim i këtillë është organizuar në shkollën "Emin Duraku" në Gjakovë, por më nuk organizohet.



## RIINTEGRIMI NË ARSIM I FËMIJËVE TË RIKTHYER

Riintegrimi i personave të riatdhesuar rregullohet me Rregulloren e Qeverisë nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar<sup>31</sup>. Ministria e punëve të brendshme është institucioni që e bën koordinimin e përgjithshëm të procesit të riintegrimit, ndërsa në këtë proces janë të përfshirë një varg institucionesh qendrore dhe lokale. Sipas rregullores, për fëmijët e riatdhesuar duhet të bëhet riintegrimi i menjëhershëm në arsim, pra ata të vendosen në shkolla dhe më tutje të përkrahen sipas nevojave të tyre për riintegrim të qëndrueshëm.

Në nivel të MASHTI-t janë ndërmarrë disa masa për të krijuar kornizën e riintegrimit në arsim të personave të riatdhesuar:

- Është nxjerrë UA 01/2016 për përcaktimin e kushteve, kritereve dhe procedurave për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit e riatdhesuar<sup>32</sup>;
- Është nxjerrë UA 16/2016 për parimet dhe procedurat njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës<sup>33</sup>;
- Janë përgatitur dhe janë siguruar tekstet për mësimin plotësues;
- Mesatarisht 200-300 nxënës në baza vjetore përfshihen në mësimin plotësues;
- Bëhet barasvlerësimi i dokumentacionit shkollor të të rikthyerve.

Fatkeqësisht nuk ka të dhëna të ndara sipas përkatësisë etnike lidhur me nxënësit e rikthyer, prandaj nga MASHTI nuk janë marrë informata të veçanta lidhur me riintegrimin në arsim të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të rikthyer. Të gjitha rastet e rikthyera trajtohen njëjtë.

Në nivelin lokal, janë zakonisht ZKKK-të që identifikojnë nevojat e të rikthyerve dhe asistojnë me institucionet e tjera të adresojnë këto nevoja. Nga këto institucione dëshmohet se më shumë nevoja për t'i adresur kanë të rikthyerit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Edhe në riintegrimin në arsim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të riatdhesuar një rol të madh e luajnë OShC-të. Organizatat bëjnë vizita të rregullta nëpër familje kur kuptojnë për familje të rikthyera. Ato ndihmojnë në identifikimin e nevojave, rregullimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e fëmijëve në shkollë.

31 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31862>

32 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/ua-masht-nr-01-2016-per-caktimin-e-kushteve-kritereve-per-mesimin-plotesues-riatdhes-imrotated.pdf>

33 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/16-ua-masht-16-2016-per-proc-e-njohjeve-te-dip-rotated.pdf>

Nga terreni raportohet për vështirësi në procesin e riintegritimit në arsim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Disa nga këto vështirësi janë:

- Shpesh fëmijëve të rikthyer u mungon dokumentacioni shkollor. Prindërit nuk mund të vërtetojnë nivelin deri ku janë shkolluar fëmijët e tyre në vendin prej nga kanë ardhur. Shkollat e bëjnë vlerësimin për të përcaktuar nivelin e shkollimit të cilin duhet ta vazhdojnë. Shpesh këtu ka mospajtime në mes të shkollave e familjeve për shkak të përcaktimit të nivelit;
- Ka probleme me nostrifikimin e dokumentacionit. Familjet duhet të bëjnë shpenzime për përkthim të certifikatave apo librezave të notave, si dhe të paguajnë për nostrifikimin. Përveç kësaj, duhet të shkojnë disa herë në ministri gjatë këtij procesi;
- Ka raste të fëmijëve që kanë probleme të theksuara me gjuhën për shkak të qëndrimit të gjatë të familjeve jashtë vendit.

Një praktikë e mirë dëftohet nga organizata Nevo Koncepti e cila ka marrëveshje me komunën e Prizrenit dhe komunën e Suharekës për mbështetjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian që riatdhesohen nga vendet e BE-së. Organizata bashkëpunon ngushtë me zyrtarin rajonal të MPB dhe me ZKKK ku për çdo muaj merren informata për familje të këtyre komuniteteve që kthehen. Pas marrjes së informatës vazhdon kontakti me familjet, marrja e informacioneve fillestare për numrin e anëtarëve të familjes, moshën, arsimin, kualifikimet/aftësitë, banimin e shëndetin. Fillimisht fëmijët kthehen në bankat shkollore, u sigurohet materiali shkollor dhe kyçen në programin e detyrave të shtëpisë. Paralelisht, organizohet përkthimi dhe nostrifikimi i dokumenteve në MASHTI. Tutorët dhe mësimdhënësit në kurs i kushtojnë vëmendje të veçantë socializimit të fëmijëve në shkollë dhe ku ka nevojë shfrytëzohet edhe ndihma e psikologut.

Gjatë vitit 2020 dhe 2021 numri i familjeve rom, ashkali dhe egjiptian që janë riatdhesuar është pakësuar. Ndonëse në MASHTI nuk kanë informata për valë të mundshme të të rikthyerve, kjo gjë paralajmërohet nga ZKKK dhe OShC-të. Këto palë thonë se duhet të jemi të gatshëm, sepse ndonëse pandemia e ka ndaluar procesin e riatdhesimit, pritet të këtë rikthime, sepse në listat e pritjes ka shume familje që pritet të rikthehen.

Për të përmirësuar bashkëpunimin në nivel komunal brenda institucioneve të ndryshme dhe palëve jointucionale, projekti i GIZ-it “Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Fillor në Kosovë (CBDE)” - komponenti i arsimit gjithëpërfshirës për të kthyerit dhe pakicat etnike, zhvilloi udhëzuesin për bashkëpunimin ndërsektorial në nivel lokal përkthimi me riintegrimin në arsim të fëmijëve të kthyer nga migrimi e sidomos fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian<sup>34</sup>. Po ashtu u hartua një doracak për profilin e ndërmjetësuesit në komunitet<sup>35</sup>. Mbi bazën e këtyre udhëzuesve, KEC ofroi një program trajnimi për bashkëpunimin ndërsektorial. Këto trajnime u ofruan për institucionet e ndryshme komunale dhe OShC-të e shumë komunave.

Në fazën vijuese GIZ-CDBE ofroi mbështetje për komunën e Podujevës, Obiliqit, Shtimes dhe Gjakovës, në

34 Bashkëpunimi ndërsektorial: Bashkëpunimi ndërsektorial në nivel lokal përkthimi me (ri)integrimin në arsim të fëmijëve të kthyer nga migrimi e sidomos fëmijëve nga komunitetet rom, ashkalinje dhe egjiptiane, GIZ, Prishtinë, shkurt 2018

35 Formësimi i profilit të ndërmjetësuesit të komunitetit në Kosovë, GIZ, Prishtinë, shkurt 2018

riintegrimin arsimor dhe gjithëpërfshirjen sociale të fëmijëve të rikthyer dhe fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Këto komuna u mbështetën në implementimin e planeve komunale të veprimit për riintegrimin në arsim të fëmijëve të rikthyer dhe fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilat plane i kishin hartuar. U ofrua mbështetje në bashkëpunimin ndërsektorial në nivel lokal, në ngritjen e kapaciteteve të shkollave për gjithëpërfshirje, etj.

## ARSIMI DHE AFTËSIMI PËR TË RRRITUR

Arsimi dhe aftësimi për të rritur ofrohet për të gjithë ata persona, moshë e të cilëve është më e madhe se moshë e paraparë në ligjin për arsimin parauniversitar për të ndjekur një nivel arsimor. Pra, këta janë persona që e kanë kaluar moshën e shkollës së mesme të lartë dhe nuk kanë diplomë të këtij niveli. Për shkak të pjesëmarrjes dukshëm më të vogël dhe braktisjes dukshëm më të madhe, sidomos në arsimin e mesëm të lartë nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, vijimi i programeve të AARr u mundëson këtyre të rinjve përfitimin nga programet e këtilla, sidomos nga programet e ndryshme profesionale, gjë që u mundëson të lidhen drejtpërdrejt me tregun e punës.

Arsimi dhe aftësimi për të rritur rregullohet me ligjin nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës<sup>36</sup>, si dhe me disa UA të MASHTI-t për çështje të veçanta lidhur me AARr.

DKA-të nga tri komunat që kanë ofruar informata për nevoja të këtij studimi kanë deklaruar se ofrohet arsimi dhe aftësimi për të rritur në komunat e tyre. Në të tria komunat ka përfitues të AARr edhe nga komunitetet rom ashkali dhe egjiptian. Në Fushë Kosovë ekziston një praktikë e lehtësimit të ndjekjes së këtij arsimi për këto komunitete, duke i liruar nga pagesa.

Të dhënat e marra nga zyra e SMIA e vërtetojnë ofrimin e programeve të AARr në këto tri komuna, por edhe në Mitrovicën Jugore, Prishtinë, Istog, Obiliq e Lipjan. Për komuna të tjera me numër të madh të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si Prizreni, Ferizaj e Peja, nuk ka të dhëna. Është vështirë të besohet se këto komuna ofrojnë programe të AARr dhe nuk ka përfitues të këtyre programeve nga këto komunitete.

36 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2868>

Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përfitues të programeve të AARr

Vitet	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21
Fushë Kosovë					
Hoxhë Kadri Prishtina	4	1	1		2
Minatori					1
Mitrovicë Jugore					
Hasan Prishtina		7		6	4
Gjakovë					
Nexhmedin Nixha		2	1		1
Podujevë					
Isa Boletini			1	1	
Istog					
Mit'hat Frashëri	1				
Prishtinë					
Shtjefën Gjeçovi	2				
Lipjan					
Adem Gllavica	14				
Obiliq					
Ismail Dumoshi			3		
<b>Gjithsej:</b>	<b>21</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>

## PROMOVIMI I DIVERSITETIT PËRMES SISTEMIT TË INTEGRUAR ARSIMOR

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar i kushton vetëm një paragraf të mësuarit për të jetuar së bashku, madje në kontekst të sfidës: “Paraqet një ndër sfidat kryesore në një botë të hapur dhe të ndërvarur, përfshirë menaxhimin konstruktiv të dallimeve, zgjidhjen paqësore të konflikteve, tolerancën, respektin për vetveten, respektin për të tjerët, mirëkuptimin ndërkulturor si dhe komunikimin efektiv...”<sup>37</sup> dhe më tej “Kjo përfshin promovimin e vlerave dhe të praktikave që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen, vizionin ndërkulturor, qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut në kontekstin e jetës publike, profesionale dhe private”<sup>38</sup>. Kompetenca qytetare është njëra nga kompetencat e parapara me kornizën e kurrikulës. Përmes saj i kontribuohet të mësuarit për të jetuar së bashku. Aty gjejmë rezultatin e të nxënësve lidhur me të vlerësuarit e diversitetit dhe demonstrimin e tolerancës, mirëkuptimit, respektit dhe qëndrimit të hapur ndaj dallimeve. Megjithatë, nuk jepen orientime bazë se si kjo të përkthehet në praktikat arsimore.


PSAK ka paraparë zhvillimin e strategjisë për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve. Në MASHTI tregojnë se nuk ekziston ndonjë strategji e tillë e veçantë. Në vitin 2018, një draft i një udhëzuesi është hartuar me OSBE-në, por nuk ka hyrë në fuqi për shkaqe politike, pasi ka qenë e lidhur më shumë me raportet me komunitetin serb.

PSAK po ashtu ka paraparë zhvillimin e një politike për organizimin e mësimdhënies për diversitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve për të gjithë nxënësit. Po ashtu është paraparë zhvillimi i moduleve arsimore specifike për komunitete. Nuk është raportuar as të jetë zhvilluar një politikë e këtillë e as të jenë zhvilluar modulet e këtilla. Megjithatë, janë një varg projektesh që janë zbatuar dhe po zbatohen në Kosovë, të cilat promovojnë kulturën demokratike të shkollave, mësimdhënien për diversitetin, tolerancën dhe bashkëjetesën, të cilat projekte në njërin anë zhvillojnë kapacitetet e udhëheqjes shkollore dhe mësimdhënësve për aspekte të vlerësimit të diversitetit dhe promovim të bashkëjetesës, e në anën tjetër kanë publikuar udhëzues, të cilët u shërbejnë profesionistëve arsimorë në punën e përditshme me klasat e shkollat e tyre gjithëpërfshirëse. Shumë nga këto projekte i ndihmojnë sistemit të arsimit në ofrimin e qasjes në arsim cilësor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kështu, një projekt që po zbatohet është projekti <sup>39</sup>, i cili po i ndërton kapacitetet e komunave dhe shkollave në këtë drejtim. Me projekte të këtilla në Kosovë janë prezente edhe organizata të tjera si Qendra IPE e Universitetit i Cyrihut për Përgatitjen e Mësimdhënësve (PHZH-IPE) dhe Qendra Evropiane Wergeland (EWC). Këto projekte rregullisht zbatohen në bashkëpunim me KEC si organizatë vendore me ekspertizë në këtë fushë dhe në ngritje të kapaciteteve arsimore, si dhe me organizata të tjera vendore. Të gjitha këto projekte mbështeten në konceptin e kompetencave për kulturë demokratike të promovuar nga Këshilli i Evropës. Ky koncept bazohet në modelin e 20 kompetencave të sistemuara në katër kategori të mëdha: vlera, qëndrime, aftësi dhe njohje e të kuptuar kritik.

37 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

38 Po aty

39 <https://pjp-eu.coe.int/en/web/building-capacity-for-inclusion-in-education/home>



Marrë nga: “Kompetencat për kulturë demokratike: Të jetojmë së bashku si të barabartë në shoqëri demokratike kulturalisht të ndryshme”<sup>40</sup>

Lidhur me promovimin e diversitetit në nivel shkolle dhe mësimdhënieje në Kosovë, nga komunat tregojnë se disa shkolla organizojnë aktivitete ndërkulturore, shpesh në bashkëpunim me OShC-të. Po ashtu, komunat ndihmojnë për organizimin e festave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërsa, lidhur me mësimdhënien për diversitet e bashkëjetesë në programet shkollore, thuhet se ajo realizohet përmes disa lëndëve shkollore. Në anën tjetër, OShC-të thonë se duhet të ketë më shumë angazhim të mësimdhënësve dhe udhëheqjes shkollore në promovimin e diversitetit dhe bashkëjetesës ndërkulturore brenda shkollës dhe jashtë saj.

40 <https://rm.coe.int/prems-128117-alb-2508-competences-for-democratic-culture-8493-txt-ëeb-/16809ca17f>

Kam parë një video të një programi shkolle në një shkollë që ka numrin më të madh të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, dhe ku asnjë nxënës nga këto komunitete nuk ka qenë i përfshirë në programin e shkollës. Arsytimi ka qenë se ata nuk kanë ditur, apo nuk kanë dashur, apo kanë pasur turp. Ajo shkollë dhe udhëheqja e asaj shkolle janë të mira “me letra”, por faktikisht jo. (Aktiviste komunitare)

Sipas përvojave të OShC-ve, duket se shpesh vetë shkollat, e posaçërisht mësimdhënësit nuk kanë njohuri për kulturat e këtyre komuniteteve, prandaj nuk kanë shkathtësi se si t'i promovojnë ato.

Pata rastin në Prishtinë të mbaj mësim me temën “Kulturat dhe gjuhët në Kosovë”. Aty kam vërejtur se asnjë pjesëtar i komunitetit shumicë nuk ka njohuri për kulturën rome, sepse në kurrikula nuk ka informata për këtë kulturë. Kur flitet për diversitetin, aty flitet për diversitetin në Amerikë, ndërsa nuk ka vend me më shumë diversitet se Kosova. Edhe mësimdhënësit nuk flasin për këto. Ata vetëm shkojnë në bazë të librit, pa hulumtuar për këtë çështje më shumë, p.sh për diversitetin. Neve na duhet më shumë kreativitet me nxënësit që t'i përgatisim e t'i formojmë si qytetarë. (mësuese e gjuhës rome).

## ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA

### NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19

Pandemia Covid-19 e prishi ekuilibrin në nivel global. Ajo vazhdon të ndikojë në shumë fusha, ndër të tjera edhe në arsim. Në Kosovë, pandemia ka përkeqësuar situatën duke rritur humbjet mësimore dhe duke thelluar pabarazitë. Ndikimi i pandemisë është reflektuar akoma më shumë në situatën me arsimimin e komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian, duke zvogëluar qasjen e tyre në mësim, duke ulur nivelin e të nxënësve, si dhe duke ndikuar në ndërveprimin social. Në studimin e realizuar së voni nga KEC mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në arsimin parauniversitar në Kosovë, lidhur me përfshirjen në mësim të fëmijëve/nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian gjatë pandemisë, ndër të tjera thuhet “Pjesëmarrja në mësim e fëmijëve nga komunitetet pakicë, si dhe e shumë fëmijëve të tjerë me të ardhura të ulëta, ishte e ulët. Për shkak të pjesëmarrjes së ulët, performanca e shumicës së këtyre fëmijëve pritet të jetë e ulët. Pjesëmarrja e ulët është e lidhur me mungesën e internetit, teknologjisë, por edhe me mungesë të materialeve mësimore.”<sup>41</sup>

41 <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Ndikimi-i-COVID19-ne-Arsimin-Parauniversitar-SHQIP.pdf>

Udhëzuesi i përgjithshëm i MASH-it për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë Covid-19<sup>42</sup>, ka tërhequr vërejtjen në thellimin e pabarazive për shkak të situatës me pandeminë, prandaj si parësore e konsideron ofrimin e mundësive të barabarta, përmes adresimit të dallimeve në procesin e nxënies. Udhëzuesi ka sugjeruar që për të siguruar qasje në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës edhe për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor, edukatorët/mësuesit duhet të jenë gjithëpërfshirës, të adaptueshëm dhe të përdorin forma të përshtatshme të punës. Raporti i përmendur më lartë mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në arsimin parauniversitar në Kosovë, ka dalë me përfundimin se “nuk ka të zhvilluar një politikë të veçantë për të shmangur thellimin e pabarazive arsimore gjatë pandemisë”<sup>43</sup>

Në muajin tetor 2021, KFOS në kuadër të projektit “Prospect 3” organizoi një punëtori dyditore për zbatimin në nivel lokal të politikave arsimore për integrimin e nxënësve rom, ashkali dhe egjiptianë, me fokus në rrethanat e pandemisë Covid-19. Në punëtori morën pjesë përfaqësues të drejtorive komunale të arsimit të 6 komunave partnere të projektit dhe përfaqësues të OShC-ve partnere në projekt. Në këtë punëtori u treguan sfidat me të cilat palët në nivelin lokal janë ballafaquar gjatë pandemisë, adaptimet apo zgjidhjet që janë bërë, si dhe mundësitë që janë hapur. Sfidë kryesore e cekur ishte aspekti i teknologjisë informative dhe lidhur me këtë u pohua se fillimisht kishte një traumë të menjëhershme, pastaj kishte vështirësi në vijueshmërinë e mësimin në distancë, mungesë të rrymës, mungesë të pajisjeve teknologjike nëpër familje, sikurse edhe përkrahje të vogël nga ana e prindërve. DKA-të dhe shkollat nuk kishin ndonjë plan të veçantë se si t’i adresonin nevojat e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian. Edhe puna e qendrave mësimore që i përkrahin fëmijët e këtyre komuniteteve pësoi ndryshime. Edhe ato u gjenden në një ndërprerje të punës së zakonshme. Qasja tash ishte më shumë reaguese, varësisht nga rasti e lokaliteti. Disa nga zgjidhjet e provuara ishin:

- Shtimi i komunikimit në mes të shkollave dhe qendrave mësimore në ndarjen e informatave/të dhënave;
- Angazhimi i tutorëve shtesë të QM-ve për të mbajtur vijueshmërinë dhe përkrahjen për fëmijët në kushte të mësimin në distancë;
- Blerja e pajisjeve elektronike për nxënësit e këtyre komuniteteve;
- Pagesa e internetit për disa familje në nevojë; etj.

42 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-i-pergjithshem-mash-07-09-2020-final.pdf>

43 <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Ndikimi-i-COVID19-ne-Arsimin-Parauniversitar-SHQIP.pdf>



## MËSIMI I GJUHËS ROME

Gjuha rome është gjuhë amtare e komuniteti rom. Sipas kushtetutës, secilit duhet t'i mundësohet që të arsimohet në gjuhën e vet. Në Kosovë, mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke, varësisht prej lokaliteteve ku gjenden shkollat. Megjithatë, situata është më ndryshe lidhur me mësimin në gjuhën rome, për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe materiale.

MASHTI ka krijuar politika për mësimin e gjuhës rome. Pra, jo të mësuarit në gjuhën rome, por të mësuarit e gjuhës rome. Mësimi i gjuhës rome si lëndë me zgjedhje është pilotuar që nga viti 2008, ndërsa që nga viti 2010 është akredituar dhe janë hartuar edhe tri tekste për nivelin e parë të njohjes së gjuhës rome. Sipas MASHTI-t planifikohet të hapet konkurs për tekstet e nivelit të dytë të gjuhës rome, si dhe për rishikimin e planprogrameve. Gjuha rome si lëndë me zgjedhje është ofruar vite më parë në disa komuna si Gjakova e Ferizaj, por nuk është arritur të mbahet për shkak të mungesës së financimit. Vetëm në komunën e Prizrenit është bërë një zgjidhje më e qëndrueshme, pasi është punësuar një mësimdhënëse rome dhe ajo e mban mësimin e gjuhës rome në katër shkolla të kësaj komune. Rreth 80 nxënës e vijojnë mësimin, përfshirë edhe 4 nxënës shqiptarë, sikurse edhe nxënës të komuniteteve të tjera.

Vite më parë kemi qenë të padukshme si komunitete rom, ashkali dhe egjiptian, duke pasur vetëm mbështetje nga donatorët dhe organizatat si KEC-i. Tash kemi si mbështetje financiare, ashtu edhe qasje të afërt nga institucionet e arsimit. (Mësuese e gjuhës rome)

Nga MASHTI thuhet se planifikohet të bëhet zgjerimi edhe në komunat e tjera. Si shembull, tregojnë se në Gjakovë është hapur thirrja për mësimdhënëës të gjuhës rome, por nuk ka pasur të kualifikuar. Këtë informatë e ka dhënë edhe komuna e Gjakovës. MASHTI njofton se është organizuar edhe mësimi në distancë në gjuhën rome dhe xhirimet gjenden në platformën "E-mësimi".

## PROFESIONISTËT ARSIMORË TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Dekada më parë numri i mësimdhënësve të kualifikuar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ishte tejet i vogël. Sipas statistikave arsimore, vit pas viti kjo situatë po ndryshon pasi një numër gjithnjë e më i madh i të rinjve të këtyre komuniteteve vijojnë studimet në arsimin e lartë, ndër ta një numër gjithnjë e më i madh në fakultetet e edukimit. Statistikat e marra nga SMIA më tutje tregojnë se shumica e studentëve të këtyre komuniteteve që regjistrohen vit pas viti në fakultetet e edukimit janë vajza, që është një përparësi tjetër. Ndërkohë, numri i të diplomuarve po rritet.

Studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të regjistruar në fakultetet e edukimit<sup>44</sup>

Studentet	Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020		
	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ
Rom	3	0	3	2	0	2	0	0	0	11	1	12
Ashkali	2	0	2	5	1	6	2	6	8	5	0	5
Egjiptian	4	1	5	3	1	4	4	1	5	2	0	2
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>12</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>13</b>	<b>18</b>	<b>1</b>	<b>19</b>

Në qendrat mësimore, para shumë vitesh ishin të angazhuar si vullnetarë nxënës të shkollave të mesme, për t'u ndihmuar fëmijëve të shkollave fillore me detyrat e shtëpisë. Sot, zor se mund të gjejmë ndonjë të tillë. Staf i QM-ve ose janë studentë, ose tashmë janë mësimdhënës të kualifikuar nga këto komunitete. Për më tepër, QM-të po inkurajojnë stafin e tyre të vijojnë studimet në fakultetet e edukimit, pasi tashmë është e domosdoshme që stafi i QM-ve të jetë me kualifikim mësimdhëniesje.

Në anën tjetër, në nivel vendi në shkollat tona janë të punësuar gjithsej 21 mësimdhënës dhe ky numër është i njëjtë me numrin e tyre në vitin 2013/14.

Mësimdhënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sipas viteve shkollore<sup>45</sup>

	2013/14	2013/14	2013/14	2013/14	2013/14	2013/14	2013/14	2013/14
	Rom	6	7	7	7	9	6	9
Ashkali	8	7	6	6	6	6	6	6
Egjiptian	7	6	6	6	5	5	6	6
<b>Gjithsej:</b>	<b>21</b>	<b>20</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>20</b>	<b>17</b>	<b>21</b>	<b>21</b>
<b>% në gjithë mësimdhënësit</b>	<b>0.09</b>	<b>0.09</b>	<b>0.08</b>	<b>0.08</b>	<b>0.09</b>	<b>0.07</b>	<b>0.09</b>	<b>0.09</b>

44 Të dhëna nga zyra e SMIA

45 Publikimet "Statistikat arsimore"

Komunat e shohin të rëndësishme rritjen e numrit të mësimitdhënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa OShC-të e shohin të domosdoshme këtë gjë. Janë listuar një varg përfitimesh nga punësimi i mësimitdhënësve të këtyre komuniteteve. KEC dhe organizatat e tjera që janë pjesë e rrjetit KRAEEN, paralelisht me përgatitjen e këtij raporti po i shfrytëzojnë të dhënat e këtij studimi, dhe po e përgatisin një dokument avokues për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit në Kosovë.

## BASHKËPUNIMI NDËRSEKTORIAL

Për shkak të rrethanave specifike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, kërkohet bashkëpunim i shumë palëve, që atyre t'u ofrohet arsimimi cilësor dhe gjithëpërfshirës. Shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërsektorial horizontal në nivelin lokal, pasi përmbushja e nevojave arsimore është e lidhur dhe varet nga sektorë të tjerë, si: sektori i gjendjes civile, sektori i shëndetësisë e i mirëqenies sociale, banimi, etj. Jo më pak i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile, marrë parasysh se në përvojat e vendit tonë, ende OShC-të janë resurse të pazëvendësueshme në arsim, sidomos në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Për nevoja të këtij studimi janë marrë opinionet e OShC-ve që janë të angazhuara në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Informatat e marra tregojnë se niveli dhe cilësia e bashkëpunimit dallojnë prej njëres komunë në tjetrën. Raportohen vështirësi në vështirim të neglizhencës dhe mosinteresimit të duhur të palëve institucionale kur bëhet fjalë për arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, vullnetit të pamjaftueshëm politik dhe komunikimit të dobët ndërinstitucional. Sidoqoftë, raportohen edhe përvoja të mira.

**Grupi këshillues për komunitete në Gjakovë vepron si trup joformal, dhe në përbërje të vet i ka OShC dhe institucionet si DKA, ZKKK, QPS, EPRMB, etj.. Vlerësojmë se si grup kemi arritur t'i unifikojmë veprimet, në njërën anë duke adresuar me efikasitet të gjitha çështjet që lidhen me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e në anën tjetër duke shmangur dyfishimin e shërbimeve apo aktiviteteve në terren (OShC nga Gjakova)**

OShC-të e shohin të domosdoshme që të formohen komisione ose ekupe ndërsektoriale brenda komunave të cilat adresojnë aspektet e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu sugjerohet që të rritet presioni dhe vullneti politik.

# PËRFUNDIME

Në fushën e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është bërë përparim i dukshëm në vitet e fundit. Është vërejtur aktivitet i shtuar i vetë anëtarëve të këtyre komuniteteve, aktivistëve dhe OShC-ve që punojnë në arsimimin e këtyre komuniteteve. Ka vazhduar përkrahja e komunitetit donator përmes projekteve në mbështetje të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por në të njëjtën kohë është artikulluar qartë kërkesa që institucionet të marrin përsipër koordinimin e veprimeve për rritjen e përfshirjes dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë edhe marrjen përsipër të financimit të këtyre veprimeve. Institucionet kanë reaguar pozitivisht. Megjithatë, në disa aspekte të arsimit të këtyre komuniteteve janë hasur vështirësi dhe janë identifikuar hapësira për përmirësime.

## Performanca e institucioneve

Në disa aspekte të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian MASHTI tashmë e ka marrë rolin si institucion udhëheqës. Në aspekte të tjera vërehen përpjekje, por po ashtu vështirësi. Komunitat, në nivel të cilave bien shumë përgjegjësi për arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, po ashtu e kanë shtuar angazhimin, megjithëse ende nuk kanë arritur ta marrin kryesimin e aktiviteteve në këtë drejtim. Shpesh qasja e komunave është reaktive, në varësi të nismave e kërkesave që vijnë nga OShC-të.

Janë hasur mungesa të të dhënave të besueshme si dhe raportim dhe monitorim jo i mjaftueshëm. Informatat nuk qarkullojnë si duhet në nivelin vertikal. Shumë aktivitete që është dashur të kryhen në nivel komunal kanë munguar, sidomos ato që lidhen me rregulloret dhe planet në nivel lokal, ndërsa nga niveli qendror nuk ka pasur monitorim. Më tutje, për aktivitetet e kryera në nivelin lokal nuk ka sistem efektiv të raportimit. Në rrethana të këtilla, njësitë administrative brenda MASHTI-t, që do të duhej të monitoronin aspekte të caktuara të arsimit të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian, nuk i kanë të dokumentuara proceset që janë në përgjegjësi të tyre. Ka qenë e sikletshme që në intervistat me udhëheqës të këtyre njësive, të marren informata të natyrës së përshtypjeve, në vend se ato të ishin të natyrës së të dhënave e fakteve.

## Roli i komunitetit donator

Agjencitë dhe organizatat donatore kanë qenë burim tejet i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Krahas fushave të tjera, shumë projekte e programe të këtyre organizatave janë drejtuar në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shumica e projekteve janë zbatuar nga organizatat vendore që kanë ekspertizë në fushën e arsimit dhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndërkohë që janë implementuar në bashkëpunim të plotë me institucionet.

Në periudhën e fundit disavjeçare agjencitë dhe organizatat donatore e kanë ngritur në një nivel tjetër bash-

këpunimin në mes tyre, duke krijuar sinergji në mes të projekteve të ndryshme, duke ekonomizuar investimet dhe duke shmangur dyfishimin a shumëfishimin e investimeve për të njëjtit përfitues, që kryesisht lidheshin me projektet në përkrahje të qendrave mësimore. Po ashtu, ato kanë vepruar të unifikuara në qëndrimin e tyre të qartë për nevojën që institucionet të marrin përsipër koordinimin e mbështetjes për arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë edhe barrën financiare.

Shumë i çmueshëm është angazhimi i komunitetit donator në ndihmën e ofruar institucioneve për të çuar përpara realizimin e politikave arsimore. Ndër të tjera kjo ndihmë është ofruar përmes përkrahjes me ekspertizë për aktet nënligjore dhe përmes zhvillimit të kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe lokale në fusha të ndryshme që lidhen me arsimimin e këtyre komuniteteve.

## Stimulimi dhe lehtësimi i regjistrimit dhe vijimit të arsimit

Në përputhje me PSAK dhe strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali, janë realizuar shumë masa për stimulimin dhe lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelet e ndryshme të arsimit. Pak më vështirë ka qenë në nivel të arsimit parashkollor, në radhë të parë sepse shkalla e përfshirjes në këtë nivel të edukimit është tejet e ulët në përgjithësi. Ndërsa, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë janë realizuar kuotat për regjistrim (së paku 5 nxënës në shkollë) të nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa veçanërisht efektive është treguar përkrahja e nxënësve të këtyre komuniteteve me bursa dhe mentorim. MASHTI këtu ka marrë koordinimin e punës me donatorët e bursave, duke hartuar kriteret për përfitim të bursave, duke nxjerrë thirrje të përbashkët në nivel vendi dhe duke siguruar mes 500 dhe 600 bursa për vit, në 6 vitet e fundit. Një pjesë e këtyre nxënësve bursistë kanë përfituar edhe nga programet e mentorimit të ofruara përmes organizatave partnere dhe projekteve të tyre.

Lehtësimi i regjistrimit të studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e lartë është bërë përmes 12% të vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë (për të gjitha komunitetet pakicë). Megjithatë ka dyshime për keqpërdorim nga ana e studentëve të shumicës etnike në këtë drejtim, ndërsa nuk është vërejtur ndonjë mekanizëm kontrolli. Lidhur me bursat, ndonëse divizioni për arsimin e komuniteteve i ka pasur 20,000 euro në vit në emër të këtyre studentëve, nuk ka mundur t'i shfrytëzojë në mungesë të bazës ligjore, gjë që ka bërë që ky fond të shkrihet në kuadër të fondit për bursa për të gjithë studentët. Lidhur me këtë, UA 14/2017<sup>46</sup> për ndarjen e bursave ndonëse i përcakton disa kategori të studentëve me përparësi, nuk i përfshin studentët rom, ashkali dhe egjiptian në këtë listë. E njëjta e metë është vërejtur edhe te UA 19/2016<sup>47</sup> për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, që nuk i përcakton në mënyrë të qartë fëmijët e këtyre komuniteteve si grup të rrezikuar apo grup të marginalizuar.

46 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/ua-masht-14-2017-per-ndarjen-e-bursave.pdf>

47 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/19-ua-nr-19-2016-per-perfshirjen-e-femijeve-ne-institucionet-parashkollore-ne-kosove-rotated.pdf>

## Puna e qendrave mësimore

Puna e qendrave mësimore ka kohë të gjatë që vlerësohet si njëri ndër kontributet më të mëdha në rritjen e përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, si dhe në përfshirjen sociale të këtyre komuniteteve. Në periudhën e fundit disavjeçare kanë ndodhur dy procese pozitive. Së pari, qendrat mësimore e kanë rritur standardin e operimit, përmes harmonizimit të programeve të tyre me kurrikulën e arsimit parau-niversitar, si dhe përmes zhvillimit profesional të stafit dhe inkurajimit të stafit për të vazhduar arsimin formal drejt kualifikimit për mësimdhënës. Së dyti, ka nisur procesi i koordinuar i institucionalizimit të qendrave mësimore. Hartimi i UA 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore<sup>48</sup> dhe i udhëzuesit për zbatimin e këtij UA e hapi rrugën për këtë proces. Tash ka nisur procesi i licencimit të QM-ve, gjë që ua mundëson QM-ve të financohen nga fondet publike.

## Adresimi i braktisjes

Braktisja e shkollës dhe mosregjistrimi mbetet një faktor që rëndon dukshëm më shumë mbi fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përkundër kornizës ligjore për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, nuk ka prova se mekanizmat në këtë drejtim janë funksionalë. EPRBM-të në nivel shkollash dhe komunash janë të themeluara, por shpesh janë jofunksionale ose joefektive. Rolin e tyre, kur është fjala për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, më shumë e luajnë OShC-të dhe ndërmjetësuesit në komunitet. Përpjekjet për të zhvilluar kapacitetet e anëtarëve të EPRBM-ve janë sporadike, në vend se të jenë sistematike e të koordinuara. Në këtë mbase ndikojnë edhe resurset e kufizuara njerëzore në nivel MASHTI. Përgjithësisht, nuk ka raportim prej poshtë-lartë për punën e këtyre EPRBM-ve. Raportimi i rasteve në modulin e paralajmërimit të hershëm është tejet i vogël. Vetëm 6 komuna dhe vetëm 14 shkolla nga këto komuna, kanë raportuar raste të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në SPH.

## Riintegrimi në arsim i fëmijëve të rikthyer

Riintegrimi në arsim i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të rikthyer bëhet brenda kornizës së përcaktuar me rregulloren qeveritare nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar<sup>49</sup>. Procesin e rikthimit e koordinon MPB dhe ky proces lavdërohet si shembull për koordinim edhe në fushat e tjera. Për fat të keq MASHTI nuk posedon të dhëna të ndara sipas përkatësisë etnike lidhur me të rikthyerit, prandaj trajtimin e riintegrimin arsimor e bën njëjtë për të gjithë fëmijët e rikthyer. Në nivelin lokal, bëhet riintegrimi i menjëhershëm në shkolla i fëmijëve të riatdhesuar, për të vazhduar pastaj sipas nevojës me vlerësimin e nivelit të nxënësve, me rregullimin e dokumentacionit dhe me kurset e gjuhës. Kur bëhet fjalë për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, raportohet për mungesë të dokumentacionit, që ndikon në vlerësimin për të përcaktuar nivelin e shkollimit të cilin duhet të vazhdojë fëmija, por edhe për vështirësi në nostrifikimin të këtyre dokumenteve. Sërish, janë OShC-të ato që bëjnë vizita të rregullta nëpër familje kur kuptojnë për familje të rikthyer. Ato ndihmojnë në identifikimin e nevojave, rregullimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e fëmijëve në shkollë.

48 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>

49 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31862>

Duke marrë parasysh rolin e madh të të gjithë sektorëve në nivelin komunal në fushën e të rikthyerve dhe ndikimin që kanë sektorët e tjerë në riintegrimin e qëndrueshëm në arsim, GIZ-CDBE ka ngritur kapacitetet e komunave për bashkëpunimin ndërsektorial në fushën e riintegritimit arsimor të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe fëmijëve me nevoja të veçanta.

## Arsimi dhe aftësimi për të rritur

Arsimi dhe aftësimi për të rritur është një aspekt i rëndësishëm i arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për shkak të pjesëmarrjes dukshëm më të vogël dhe braktisjes dukshëm më të madhe, nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sidomos në arsimin e mesëm të lartë. Vijimi i programeve të AARr u mundëson këtyre të rinjve përfitimin nga programet e këtilla, duke ua mundësuar të lidhen drejtpërdrejt me tregun e punës.

Në SMIA ka të dhëna për 8 komuna në të cilat gjatë 5 viteve të fundit nga programet e AARr kanë përfituar pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Janë së paku edhe tri komuna me numër të madh të këtyre komuniteteve që nuk figurojnë në këto statistika dhe kjo shtrton pikëpyetje në këtë drejtim.

Nuk ka prova për ndonjë strategji apo qasje të veçantë për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me AARr. Edhe këtu trajtimi është i njëjtë, me përjashtime. Kështu, një praktikë e mirë është ajo e Fushë Kosovës, ku pjesëtarët e këtyre komuniteteve lirohen nga pagesat për ndjekjen e programeve të AARr.

## Promovimi i diversitetit përmes sistemit arsimor

Promovimi i diversitetit përmes sistemit arsimor është përgjegjësi e secilës palë brenda sistemit të arsimit, duke filluar prej nivelit qendror e deri te mësimdhënësit. Ndonëse me PSAK ishte paraparë zhvillimi i një strategjie për promovimin e dialogut ndëretnik dhe kontakteve mes komuniteteve, si dhe zhvillimi i një politike për organizimin e mësimdhënies për diversitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve për të gjithë nxënësit, këto dokumente nuk janë zhvilluar. Po ashtu, nuk është raportuar të jenë zhvilluar module arsimore specifike për komunitete. Këtë zbrazëti e kanë mbuluar projektet e implementuara dhe ato që implemen-tohen nga agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë ngritur kapacitetet e udhëheqjeve shkollore dhe të mësimdhënësve, si dhe kanë ofruar udhëzues praktikë për kompetencat për kulturën demokratike në shkolla, që promovon diversitetin, tolerancën dhe bashkëjetesën.

Megjithatë, nga përvoja e OShC-ve dhe aktivistëve që punojnë në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në shkolla dhe klasa ka fare pak shembuj të të mësuarit për diversitetin, dhe të prezantimit të kulturave të këtyre komuniteteve. Mësimdhënësit shpesh nuk kanë kompetenca në këtë drejtim, pasi në radhë të parë vetë nuk i njohin kulturat e këtyre komuniteteve. Kësisoj, zakonisht mësimdhënësit nuk dalin nga zona e komfortit, për të hulumtuar burime alternative të cilat do t'i trajtonin në klasat e tyre.

## Ndikimi i pandemisë Covid-19

Në Kosovë, pandemia ka përkeqësuar situatën duke rritur humbjet mësimore dhe duke thelluar pabarazitë. Pandemia ndikoi më rëndë në situatën me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke zvogëluar qasjen e tyre në mësim, duke e ulur nivelin e të nxënësve, si dhe duke kufizuar ndërveprimin social. Ndonëse MASH pati tërhequr vërejtjen në thellimin e pabarazive për shkak të pandemisë dhe pati sugjeruar gjithëpërfshirjen, adaptimin dhe format e përshtatshme të punës me fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, kjo ishte e vështirë në praktikë. DKA-të dhe shkollat nuk kishin ndonjë plan të veçantë se si t'i adresonin nevojat e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian. Qendrave mësimore po ashtu iu vështirësua puna. Përmes një qasjeje reaktive, QM-të shtuan stafin e tyre për të realizuar ndihmë të individualizuar, ndërsa në bashkëpunim me institucionet dhe donatorët u bë përkrahja e fëmijëve me pajisje elektronike, sikurse edhe e familjeve me internet.

## Mësimi i gjuhës rome

Mësimi i gjuhës rome u testua dhe më pas u akreditua nga MASHTI. Janë hartuar tri tekste për nivelin e parë të njohjes së gjuhës rome, ndërsa MASHTI planifikon të hapë konkurs për tekstet e nivelit të dytë të gjuhës rome, si dhe për rishikimin e planprogrameve. Derisa gjuha rome si lëndë me zgjedhje është ofruar vite më parë në disa komuna si Gjakova e Ferizaji, nuk është arritur të mbahet. Vetëm në komunën e Prizrenit është bërë një zgjidhje më e qëndrueshme, pasi është punësuar një mësimdhënëse rome dhe ajo e mban mësimin e gjuhës rome në katër shkolla të kësaj komune. Është inkurajues fakti se ka interesim të ndjekjes së lëndës së gjuhës rome edhe nga disa nxënës shqiptarë, sikurse edhe nga nxënës të komuniteteve të tjera. MASHTI planifikon zgjerimin edhe në komunat e tjera, por duket se në konkurset për mësimdhënëse të gjuhës rome nuk ka interesim për aplikime nga mësimdhënëse të kualifikuar.

## Profesionistët arsimorë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Numri i studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që i ndjekin studimet në fakultetet e edukimit po rritet vit pas viti, rrjedhimisht edhe numri i të diplomuarve nga këto komunitete. Megjithatë, nuk shihet rritje e numrit të mësimdhënësve të këtyre komuniteteve që punësohen në shkollat publike në Kosovë. Deri tash institucionet nuk kanë marrë masa për të rritur numrin e të punësuarve nga këto komunitete dhe në vend të kësaj kanë zgjedhur qasjen e trajtimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë etnike. Ndërkohë, të gjitha palët e konsiderojnë të rëndësishme rritjen e punësimit të mësimdhënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollat tona.



## **Bashkëpunimi ndërsektorial**

Përmbushja e nevojave arsimore të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është e lidhur dhe varet nga sferat e tjera të jetës si: gjendja civile, shëndeti, mirëqenia sociale, banimi, etj. Prandaj, bashkëpunimi ndërsektorial horizontal në nivelin lokal është shumë i rëndësishëm, sidomos kur bëhet fjalë për reagimin ndaj braktisjes dhe për riintegrimin arsimor të fëmijëve të rikthyer. Në këtë mes futet edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile, marrë parasysh se në përvojat e vendit tonë, ende OShC janë resurse të pazëvendësueshme në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në përvojat e OShC-ve që janë të angazhuara në arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, niveli dhe cilësia e bashkëpunimit dallojnë prej njëres komunë në tjetrën. Raportohen vështirësi në vështrim të neglizhencës dhe mosinteresimit të duhur të palëve institucionale, vullnetit të pamjaftueshëm politik dhe komunikimit të dobët ndërinstytucional. Megjithatë, ka edhe shembuj të mirë të veprimit ndërinstytucional

## REKOMANDIME

Nga analiza e të dhënave të mbledhura dhe informatave të shqyrtuara përmes këtij studimi dhe nga përfundimet e nxjerra, shihet se lidhur me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, ka përparime të dukshme në disa nga aspektet dhe këto prezantohen përmes treguesve pozitivë si dhe përmes praktikave të mira. Megjithatë, ka edhe aspekte të rëndësishme ku ka vështirësi e ngecje dhe ku ka hapësirë për përmirësim. Si nga aspektet ku janë identifikuar vështirësi, ashtu edhe nga praktikat e mira janë nxjerrë disa rekomandime, të cilat do t'u ndihmojnë në punën e tyre në radhë të parë institucioneve, por edhe OShC-ve dhe palëve të tjera. Rekomandimet janë dhënë më poshtë:

- Si PSAK-u, ashtu edhe strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë në fazën fillestare të planifikimit për periudhën e ardhshme strategjike. Deri tash, institucionet nuk kanë publikuar ndonjë raport të vlerësimit të zbatimit të strategjive ekzistuese që përfundojnë këtë vit. Mbase ky vlerësim do të jetë pjesë e analizës së gjendjes, si një hap i rëndësishëm i planifikimit të ciklit tjetër strategjik. Sidoqoftë, duhet të shfrytëzohen një varg publikimesh të bëra nga palë të ndryshme, që u referohen çështjeve lidhur me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- MASHTI duhet të sigurojë mekanizma të qartë kontrolli për zbatimin e masave që do të parashihen në planin e veprimit të PSAK për periudhën e ardhshme, në mënyrë që institucionet që do të përcaktohen si përgjegjëse për udhëheqje apo përkrahje të atyre masave, me të vërtetë të veprojnë sipas përgjegjësisë;
- Duhet të përmirësohet komunikimi në mes të komunave dhe MASHTI-t, të sigurohet raportim i rregullt në njërën anë dhe monitorim i duhur në anën tjetër, si dhe të mirëmbahet një sistem efektiv i dokumentimit të proceseve, pasi ato shërbejnë për vendimmarrje të informuar më tutje;
- Gjatë hartimit dhe rishikimit të politikave, ligjeve e akteve nënligjore, MASHTI duhet të ketë qasje konsistente lidhur me përcaktimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si grup i cënueshëm në arsim dhe lidhur me masat e posaçme për ta. Kështu, UA 14/2017<sup>50</sup> për ndarjen e bursave duhet të rishikohet dhe të përfshijë studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si kategori me përparësi dhe kjo të reflektohet pastaj edhe në thirrjen për bursa për studentët. E njëjta duhet të bëhet me UA 19/2016<sup>51</sup> për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, dhe të përcaktohen në mënyrë të qartë fëmijët e këtyre komuniteteve si grup i marginalizuar (i cënueshëm);
- MASHTI duhet ta mbajë planifikimin e përvitshëm të buxhetit për bursat e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të shkollave të mesme të larta dhe për financimin e qendrave mësimore. Sipas mundësive, duhet marrë në konsideratë rritja e buxhetit për financimin e qendrave mësimore;

50 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/ua-masht-14-2017-per-ndarjen-e-bursave.pdf>

51 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/19-ua-nr-19-2016-per-perfshirjen-e-femijeve-ne-institucionet-parashkollore-ne-kosove-rotated.pdf>

- MASHTI duhet t'i lirojë nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga pagesa për nostrifikimin e dokumenteve dhe ta lehtësojë sa më shumë këtë proces;
- MASHTI duhet t'i shfrytëzojë praktikën e mira në nivel të ndonjë komune dhe të kujdeset për shpërndarjen e tyre në komunat e tjera. Praktika të tilla si: funksionimi efektiv i grupit këshillues për komunitete në Gjakovë; mësimi i gjuhës rome si lëndë me zgjedhje në Prizren; apo rezervimi i një numri bursash të ofruara nga komuna e Gjakovës, për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mund të ndahen përmes organizimit të ngjarjeve publike për prezantim të praktikave të mira, vënies së informatave në ueb faqe të MASHTI dhe në rrjetet sociale, organizimit të shkëmbimit në mes komunave në formën e vizitave studimore, etj. Këtë mund të bëjnë edhe vetë komunat ose të bëhet në bashkëpunim;
- Në mënyrë që të promovohet diversiteti, përfshirja sociale dhe të kuptuarit ndërkulturor, MASHTI duhet të nxjerrë një politikë arsimore për promovimin e kulturës demokratike në shkolla, të bazuar në konceptin e Këshillit të Evropës të Kompetencave për Kulturë Demokratike<sup>52</sup>. Për të zbatuar këtë politikë, mund të shfrytëzohen programet e trajnimit në këtë fushë që tashmë janë pilotuar në shkollat e Kosovës dhe janë të akredituara nga MASHTI;
- Është e nevojshme të mbahet e promovohet kultura dhe gjuha rome. Prandaj duhet të shihet mundësia e hapjes së katedrës së gjuhës rome në universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI duhet të vazhdojë përpjekjet për promovimin e gjuhës rome, duke hartuar tekstet shtesë, duke vazhduar me trajnimin e mësimdhënësve për mësimdhënie të gjuhës rome dhe duke rishikuar planprogramin e lëndës së gjuhës rome si lëndë me zgjedhje;
- Komunat, sidomos ato që kanë pjesëtarë të komunitetit rom, duhet të sigurojnë mësimin e gjuhës rome dhe të punësojnë mësimdhënës të gjuhës rome;
- Komunat ku komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë me përqendrim më të madh, duhet ta marrin përsipër punësimin e ndërmjetësuesit në komunitet<sup>53</sup>, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e veprimit në një sërë çështjesh të lidhura me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e ku ndikimi i ndërmjetësuesit në komunitet mund të jetë shumë i madh;
- Komunat duhet që brenda mundësive të marrin përsipër mbulimin e shpenzimeve komunale (dhe ndonjë shpenzimi tjetër) për qendrat mësimore me bazë në komunitet;
- Komunat duhet të marrin përsipër sa më shumë të jetë e mundur punësimin e mësimdhënësve të angazhuar në qendrat mësimore me bazë në shkollë;

52 <https://www.living-democracy.com/sq/kompetencat-per-kulture-demokratike/>

53 Formësimi i profilit të ndërmjetësuesit të komunitetit në Kosovë, GIZ, Prishtinë, shkurt 2018

- Komunitetet duhet që brenda kornizës ligjore, në konkursin për rekrutimin e mësuesve në shkollë, të përcaktojnë që në kushte të plotësimi të njëjtë të kriterëve të rekrutimit, përparësi në punësim të kenë mësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Komunitetet duhet të përqendrohen në bashkëpunimin ndërsektorial, për të adresuar riintegrimin e qëndrueshëm arsimor të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të rikthyer, por edhe për adresimin e nevojave të tjera arsimore të fëmijëve të këtyre komuniteteve. Udhëzuesi i publikuar nga GIZ-CDBE “Bashkëpunimi ndërsektorial”<sup>54</sup> i cili është shpërndarë në të gjitha komunitetet mund të shërbejë për udhëzim në këtë drejtim.
- Komunitetet dhe shkollat duhet të nxisin përfshirjen aktive të prindërve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin e fëmijëve të tyre. Kjo nënkupton edhe trajnimin e prindërve që të përmbushin detyrat e tyre prindërore në mbështetjen e fëmijëve të tyre në aspekte të të nxënësve.

---

54 Bashkëpunimi ndërsektorial: Bashkëpunimi ndërsektorial në nivel lokal përkitazi me (ri)integrimin në arsim të fëmijëve të kthyer nga migrimi e sidomos fëmijëve nga komunitetet rom, ashkalinje dhe egjiptiane, GIZ, Prishtinë, shkurt 2018

# REFERENCAT

OHCHR, Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, [https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf), qasur së fundmi më 12 nëntor 2021

UNICEF, Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijës, <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>, qasur së fundmi më 12 nëntor 2021

UNDP, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, [https://www.undp.org/sustainable-development-goals?utm\\_source=EN&utm\\_medium=GSR&utm\\_content=US\\_UNDP\\_PaidSearch\\_Brand\\_English&utm\\_campaign=CENTRAL&c\\_src=CENTRAL&c\\_src2=GSR&gclid=Cj0KCQIAkNiMBhCxARIsA-IDDKNVUBucU4mGGEuej0c97RIrupLMNWgEMSBg9eY7\\_vozYrL253E0LtTQaAkzIEALw\\_wcB](https://www.undp.org/sustainable-development-goals?utm_source=EN&utm_medium=GSR&utm_content=US_UNDP_PaidSearch_Brand_English&utm_campaign=CENTRAL&c_src=CENTRAL&c_src2=GSR&gclid=Cj0KCQIAkNiMBhCxARIsA-IDDKNVUBucU4mGGEuej0c97RIrupLMNWgEMSBg9eY7_vozYrL253E0LtTQaAkzIEALw_wcB), qasur së fundmi më 13 nëntor 2021

CoE, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, <https://rm.coe.int/16800c131a>, qasur së fundmi më 12 nëntor 2021

Gazeta zyrtare e R. së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, qasur së fundmi më 15 nëntor 2021

MASHTI, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, [https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf), qasur së fundmi më 27 nëntor 2021

ZKZQM, Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA\\_PER\\_PERFSHIRJEN\\_E\\_KOMUNITETEVE\\_ROM\\_DHE\\_ASHKALI\\_NE\\_SHOQERINE\\_KOSOVARE\\_2017-2021.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA_PER_PERFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NE_SHOQERINE_KOSOVARE_2017-2021.pdf), qasur së fundmi më 27 nëntor 2021

Gazeta zyrtare e R. së Kosovës, Ligji nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>, qasur së fundmi më 15 nëntor 2021

Gazeta zyrtare e R. së Kosovës, Ligji nr. 03/l-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>, qasur së fundmi më 15 nëntor 2021

Gazeta zyrtare e R. së Kosovës, Ligji nr. 04/l-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2868>, qasur së fundmi më 23 nëntor 2021

MASHTI, UA 09/2016 për aplikimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>, qasur së fundmi më 24 nëntor 2021

MASHTI, UA 14/2017 për ndarjen e bursave, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/12/ua-masht-14-2017-per-ndarjen-e-bursave.pdf>, qasur së fundmi më 24 nëntor 2021

MASHTI, UA 01/2016 për përcaktimin e kushteve, kritereve dhe procedurave për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit e riatdhesuar, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/ua-masht-nr-01-2016-per-aktimin-e-kushteve-kritereve-per-mesimin-plotesues-riatdhesimrotated.pdf>, qasur së fundmi më 24 nëntor 2021

MASHTI, UA 16/2016 për parimet dhe procedurat njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/16-ua-masht-16-2016-per-proc-e-njohjeve-te-dip-rotated.pdf>, qasur së fundmi më 25 nëntor 2021

Komisioni Evropian, Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2016, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2018-12/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2018-12/20161109_report_kosovo.pdf), qasur së fundmi më 27 nëntor 2021

Komisioni Evropian, Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Kosovën 2021, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en), qasur së fundmi më 27 nëntor 2021

OSBE, Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, [https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590_2.pdf), qasur së fundmi më 27 nëntor 2021

MASHTI, UA 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>, qasur së fundmi më 29 nëntor 2021

MASHTI, Udhëzues për zbatimin e UA 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/12/udhezues.pdf>, qasur së fundmi më 29 nëntor 2021

MASHTI, UA 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obligueshëm, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8222>, qasur së fundmi më 26 nëntor 2021

MAShTI, UA 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaja braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu.pdf>, qasur së fundmi më 26 nëntor 2021

MAShTI, UA 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/19-ua-nr-19-2016-per-perfshirjen-e-femijeve-ne-institucionet-parashkollore-ne-kosove-rotated.pdf>, qasur së fundmi më 29 nëntor 2021

MAShTI, doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, [https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim_1.pdf), qasur së fundmi më 26 nëntor 2021

Interaction Institute for Social Change, #the4thBox Cut-out Edition, <https://interactioninstitute.org/the4th-box-cutout/>, qasur së fundmi më 22 nëntor 2021

UNICEF, Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë – MICS, <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1936/file/MICS%20Snapshots%20.pdf>, qasur së fundmi më 23 nëntor 2021

UBO Consulting, Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, [http://uboconsulting.com/PDF/al/Study\\_on\\_Impact\\_and\\_Sustainability\\_of\\_the\\_Learning\\_Centers-ALB.PDF](http://uboconsulting.com/PDF/al/Study_on_Impact_and_Sustainability_of_the_Learning_Centers-ALB.PDF), qasur së fundmi më 24 nëntor 2021

KEC, Ndikimi i qendrave mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, [http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove\\_alb.pdf](http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove_alb.pdf), qasur së fundmi më 22 nëntor 2021

KEC, Raport vlerësues mbi efektivitetin e EPRBM-ve, [http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raport\\_i\\_fokusuar\\_ne\\_efektivitetin\\_e\\_eprbm-ve\\_te\\_femijet\\_rome\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptian-1\\_ALB.pdf](http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raport_i_fokusuar_ne_efektivitetin_e_eprbm-ve_te_femijet_rome_ashkali_dhe_egjiptian-1_ALB.pdf), qasur së fundmi më 26 nëntor 2021

Gazeta zyrtare e R. së Kosovës, Rregullore (QRK) nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31862>, qasur së fundmi më 23 nëntor 2021

KEC, Ndikimi i pandemisë COVID-19 në arsimin parauniversitar në Kosovë. <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Ndikimi-i-COVID19-ne-Arsimin-Parauniversitar-SHQIP.pdf>, qasur së fundmi më 29 nëntor 2021

MAShTI, Udhëzues i përgjithshëm i MASH për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-i-pergjithshem-mash-07-09-2020-final.pdf>, qasur së fundmi më 27 nëntor 2021

Handrich, T. (2018). Formësimi i profilit të ndërmjetësuesit të komunitetit në Kosovë, GIZ, Prishtinë, shkurt 2018

Muller, S. (2018). Bashkëpunimi ndërsektorial: Bashkëpunimi ndërsektorial në nivel lokal përkitazi me (ri) integrimin në arsim të fëmijëve të kthyer nga migrimi e sidomos fëmijëve nga komunitetet rome, ashkalinje dhe egjiptiane, GIZ, Prishtinë, shkurt 2018

CoE, Kompetencat për kulturë demokratike: Të jetojmë së bashku si të barabartë në shoqëri demokratike kulturalisht të ndryshme. <https://rm.coe.int/prems-128117-alb-2508-competences-for-democratic-culture-8493-txt-web-/16809ca17f>, qasur së fundmi më 29 nëntor 2021







Funded by  
the European Union

